


bjektiv

Viti I i botimit

Nr. 3

Tetor

Çmimi 250 Lekë - 2 euro



*Kim Mehmeti:
Shqiptarët nuk
mund të bashkohen
me Evropën
me mendësi të
copëzuar*

Sociale

Fëmijët pëballë botës
digjitale

Reportazh

Kthim mbrapa në
burgun e Spaçit

Shëndetësi

Kujdes nga përdorimi
i antibiotikëve

Të çmendur pas internetit



**Super Internet 3.5G, Falas
Internet Wi-Fi në të gjithë Shqipërinë, Falas
Modem USB Eagle Speed, Falas
Internet ADSL 4 Mbps**

Për më shumë informacion, vizito www.albtelecom.al ose telefono Kujdesin për Klientin në 123.





**Kujdesuni për shëndetin tuaj
Parandaloni sot kancerin e gjirit!**

Objektiv

Kryeredaktor
Ramadan Çipuri

Redaksia
Alba Boriçi
Ana Koldashi
Emirjon Senja
Erlis Çela
Ilda Shytaj
Rudi Dunga
Romelda Qose

Grupi i këshilltarëve
Agron Hoxha
Agron Tufa
Alban Tartari
Briseida Mema
Gentiana Skura
Idaver Sherifi

Këshilli i etikës
Aleksandër Çipa
Bashkim Gjergji
Lutfi Dervishi
Mark Marku

Kontribuan në këtë numër
Borana Belegu
Blerand Ismaili
Osman Stafa
Rovena Xhili
Xhevahir Qardaku

Redaktor letrar
Rrahim Ombashi

Marketingu
Rudi Dunga
Erzen Carja

Dizajni
Ejup Lila

Fotografia
Irfan Karaabo

Telefon
+355 42 419 222
+355 67 30 44 464

Adresa: Rr. Jordan Misja, Kompleksi Usluga,
Tiranë - Shqipëri

Editorial

Të presim pak kohë... , nga Ramadan Çipuri

Intervistë

Intervistë me shkrimtarin dhe publicistin e njohur, Kim Mehmeti.
Intervistoi: Erlis Çela

Aktualitet

Ligji për nëpunësit civilë, PD-PS "luftë" për militantët, nga Emirjon Senja

Opinion

Kur demokracia bëhet sheqer... , nga Alban Tartari

Ekonomi

Ekonomia, probleme të vjetra për qeverinë e re, nga Emirjon Senja

Opinion

Marrëdhëniet me publikun – domosdoshmëri për trashëgiminë kulturore shqiptare, nga Gentiana Skura

Opinion

Revanshi i antivlerave dhe kultura e mosreagimit, nga Erlis Çela

Sociale

Fëmijët dhe teknologjia: Si të rrisim fëmijë të shëndetshëm në një botë digjitale? , nga Ana Uka

Sociale

10 mënyra të thjeshta se si mund të rrisni fuqinë e mendjes suaj - nga Rovena Xhili

Panshqiptare

"Njohjet e Kosovës në prag të 6-vjetorit të Pavarësisë" , nga Rudi Dunga

Reportazh

Elbasani, qyteti që po vdes nga industria , nga Osman Stafa

Opinion

Tre dimensionet e komunikimit , nga Redi Shehu

Shëndetësi

Antibiotikët dhe rreziku i përdorimit të tyre pa kriter , nga Arjet Gega

Reportazh

Kthim mbrapa në kohë në burgun e Spaçit , nga Xhevahir Qardaku

Opinion

Identiteti "Online" dhe "Offline" , nga Skënder Bruçaj

Reportazh

Pogradeci, aty ku edhe mali u dogj nga dashuria për liqenin , nga Borana Belegu

Dossier

Fati tragjik i shkrimtarit dhe publicistit Petro Marko midis fashizmit dhe komunizmit, nga Hasan Bello

Teknologji

Telefonat fleksibël, nga Ejup Lila

Sport

Misioni "De Biazi" dështoi? , nga Blerand Ismaili



Nga Ramadan Çipuri



Të presim pak kohë...

Pas zgjedhjeve të 23 qershorit, Shqipëria ka hyrë në një fazë disi ndryshe nga ajo që qe më parë. Kemi një qeveri të re, një kryeministër të ri për herë të parë në një detyrë të tillë, një skemë krejt ndryshe nga ç'pritej apo ç'mund të pretendonin të majtët, apo elektorati në përgjithësi. Mënyra e re e realizimit të gjërave ka ngjallur edhe reagime të grupeve të ndryshme brenda apo jashtë mazhorancës së drejtuar nga kryeministri Edi Rama. Me pak fjalë, shumë kush e ka akuzuar dhe po vazhdojnë ta akuzojnë atë për mënyrën se si po vepron, për emërimet në poste të rëndësishme etj.

Shumë analistë e akuzuan kryeministrin Rama për kabinetin, akoma më shumë për vajzat e reja pa eksperiencën e nevojshme për të qenë në pozicione të vështira të administratës. Rrjetet sociale vluan nga shakatë, ku me kripë e ku pa kripë, rreth të ashtuquajturave "bukuroshet e Ramës." Dikush tjetër i ashpërsoi kritikën për "një qeveri kukull", ku Rama do t'iu tërhiqte veshin gjithkujt në kabinet apo në nivele më të ulëta të administratës. Shumë të tjerë komentuan dhe vazhdojnë të shprehën skeptik ndaj paqartësive të deri më tanishme midis premtimeve elektorale dhe programit qeveritar. Fotot nga institucionet shtetërore të hedhura në rrjete sociale u menduan si sjellje politike në përpjekje për të treguar një sukses sipërfaqësor në një kohë të shkurtër nga ana e qeverisë.


Por, nga ana tjetër, Shqipëria ka kaluar një periudhë tetë vjeçare, sa të suksesshme gjatë këtyre viteve në infrastrukturë, në ekonominë e ruajtur nga kriza që pushtoi mbarë globin, po aq edhe problematike ndaj çështjeve sociale, ndaj krizës me të cilën qytetarët përballëshin në dyert e administratës shtetërore, ndaj mospërfilljes dhe mungesës së shërbimit në spitale, ndaj sjelljeve të dhunshme e të rëndomta të policëve rrugorë dhe sidomos ndaj korrupsionit, i cili ka kapluar në të gjitha këto hallka të funksionimit të një shteti normal.

Pas 23 qershorit, kryeministri Rama duket se ka ndjekur një rrugë të re, krejt ndryshe nga ajo që kemi parë përgjatë gjithë rrugëtimin tonë në këtë tranzicion të zgjatur. Një kabinet qeveritar i bindur ndaj shefit, elementë të rinj të zgjedhur krejt ndryshe nga

ekspertët e mëparshëm të së djathtës. Të gjitha këto, në syrin e parë duken si problematike, sikur nuk do të japin një zgjidhje përkundrejt Shqipërisë së rrënuar edhe pas 22 vitesh pluralizëm. Duket sikur nuk premtojnë një rilindje të premtuar. Por, pavarësisht të gjithave, z.Rama ka bërë një premtim publik. Në të ai premtonte se brenda katër viteve do të hyjë në histori me ndryshimet që do të bëjë, në të kundërt do të largohet nga politika. Është e nevojshme apo jo t'i japim kohë për të mbajtur premtimin, kjo nuk mund të diskutohet më. Ishte vullneti i popullit që e solli në pushtet.

Përballë të gjitha kritikave ndaj tij, kur ne kemi provuar qeveri nga më arrogantet, nga më të korruptuarat, besoj se është koha që ti lëmë kohë kryeministrit të ri dhe qeverisë që ai drejton. Nuk është e udhës që të kritikohet kaq shpejt puna e një qeverie që akoma nuk ka ardhur në pushtet. Duhet pritur për rezultate të paktën për një periudhë një vjeçare, për të adresuar edhe kritikën e para. Dihet shumë mirë ndryshimi që z. Rama i bëri Tiranës në momentin kur u zgjodh për herë të parë kryetar i bashkisë së Tiranës. Prandaj, pavarësisht çdo politike dhe mënyre pune që kryeministri ka zgjedhur të bëjë, i duhet lënë kohë për gjykim. Fundja, mazhoranca që ai drejton ka marrë votëbesimin e dy të tretave të shqiptarëve, prandaj duhet treguar durim.

Përballë një mazhorance të tillë të konsoliduar e që e solli fati që të ketë një numër të konsiderueshëm deputetësh që të bënë të mendosh për një sistem monist me një drejtim të caktuar qeverisjeje. Kemi një opozitë që sido të sillet, nuk ka më asnjë ndikim në vendimmarrje. Një opozitë inekzistente me votën e saj në legjislativ. Me situatën e re të krijuar me lidërshipin e ri, të djathtës shqiptare i duhet të mos bjerë në gabimet e së majtës në mandatin e kaluar. Duhet t'i largohet bojkotit pasi ai nuk ka vlerë. 84 votat e së majtës bëjnë të pavlefshme çdo kapriço të së djathtës. Në një situatë të tillë, opozitës i duhet të qëndrojë në sallën e parlamentit dhe të bëjë një opozitë të fortë, duke qenë prezente në çdo zhvillim, duke dhënë kontributin e saj në rrugën e integritit dhe duke kundërshtuar paudhësitë e një mazhorance të madhe.



Kim Mehmeti: Shqiptarët nuk mund të bashkohen me Evropën me mendësi të copëzuar

Intervistë me shkrimtarin dhe publicistin e njohur, Kim Mehmeti

Intervistoi: Erlis Çela

Shkrimtari dhe publicisti i njohur shqiptar Kim Mehmeti vjen përballë lexuesit shqiptar me idetë dhe opinionet e tij mbi letërsinë, shqiptarët dhe “Shqipëritë” e tyre në Ballkan. Ai shprehet se shqiptarët janë popull i vetmuar në Ballkan dhe si të tillë duhet të ndërtojnë marrëdhëniet me fqinjët, duke mos harruar asnjëherë të shkuarën. Sipas tij, shqiptarët po jetojnë shekullin e tyre po që ende nuk kanë gjetur paqen me vetveten. Si gjithnjë i preokupuar për pozicionin e bashkëkombësve të tij në Maqedoni, Kim Mehmeti kërkon që Shqipëria të marrë më shumë rol kujdestarie ndaj atyre shqiptarë që jetojnë jashtë kufijve zyrtar. Ai kërkon një Shqipëri, e cila ka zgjidhur problemet mes vetes dhe që me përparimin e arritur do të bënte krenar të gjithë shqiptarët përtej kufijve. Gjithashtu, ai shpjegon edhe raportin që ka ndërtuar mes shkrimtarit dhe publicistit dhe se si mundohet që t’i mbajë larg njëri-tjetrit këta të dy. Kim Mehmeti ndjehet më i vlerësuar si shkrimtar në Tiranë dhe në Prishtinë dhe kjo e bën të veçantë marrëdhënien e tij me lexuesin shqiptar. Duke e cilësuar veten si një “letrar që jeton me barrën që i takon njeriut publik” flet për të ardhmen e bashkëjetesës së shqiptarëve me maqedonasit. Ai kumton edhe për kostot që mund të kenë për shqiptarët e Kosovës marrëveshjet e reja me Serbinë.

Çfarë është letërsia për ju, sa ka ecur letërsia shqipe dhe ku ndodhemi në raport me fqinjët tanë?

Kim Mehmeti: Letërsia për mua është “perandoria” ime, e cila ka vetëm një ndërtues: imagjinatën time! Dhe, përgjithmonë i përmbahem parimit se imagjinata është ajo që “ndërton”, duke përdorur lëndën e parë ndërtuese që e prodhon fantazia, por pronari i asaj punëtorie, shkrimtari në mua, duhet të mbajë llogari se jo e tërë “lënda e parë” mund të zbardhet në letër. Unë besoj se të gjithë janë nga pak krijues, përderisa të gjitha kanë imagjinatë, por jo të gjithë njerëzit janë të zotët që ta mirëmbajnë atë punëtori që përmenda më lartë dhe jo të gjithë kanë shpatulla për të mbajtur mbi to peshën e jetës së dyzuar. Nuk e besoni se të gjithë jemi nga pak krijues?! Ja një shembull! Thuajse të gjithëve na ka ndodhur të kalojmë orë të tëra me ndonjë mikeshë, apo me shokët në kafene, e kur jemi kthyer në shtëpi, gruas i jemi arsyetuar me rrëfimin e trilluar për mbledhjen e lodhshme e të mundimshme me punëdhënësit, pra duke aktruar e duke trilluar rrëfim për atë që nuk na ka ndodhur! Pra, duke “hyrë” në rolë si aktor i mirëfilltë e duke përshkruar ngjarje të imagjinuar, duke u prezantuar të tillë siç nuk jemi. Për dallim nga “arti” që të gjithëve na bënë

“artistë” e na mundëson të prezantohemi të atillë siç do na pëlqente të na shohin të tjerët, arti i mirëfilltë u takon vetëm atyre që merren me të, jo që të jenë të pëlqyer nga tjerët, por pse ashtu u pëlqen vetvetja. Pra, u takon atyre që e jetojnë dhe e shpalosin dybotëshin e vet duke i shlyer kufijtë mes asaj bote që i rrethon nga jashtë dhe botës që i rëndon nga brenda.

Duke e parë krijimtarinë letrare si të tillë, besoj se as shkrimtarët, as letërsitë si tërësi, nuk mundet aq lehtë të krahasohen mes veti. Si për shembull, garuesit sportivë. Ata që merren me artë nuk i kushtojnë rëndësi se kush vrapon para, e cili ka mbetur pas krahëve të tyre. Letërsinë dhe artin e bëjnë ata që garojnë me vetveten. Andaj, letërsia shqiptare e kohës së socializmit e jetoj periudhën kur sunduesit ideologjikë e vrisnin krijuesin. Sot ajo e jeton epokën kur “hajdutokratët” e vrasin letërsinë. Këto dy situata krejt të ndryshme “prodhojnë” edhe vepra që nuk mund të krahasohen mes veti. Letërsia e sotme shqiptare ka vetëm një të përbashkët me atë të djeshmen socialiste: ajo ende zhvillohet e copëtuar sipas “principatave kulturore” që në numër janë aq sa që kemi “Shqipëri” të ndara me kufij, kufij të cilët nuk e pengojnë vetëm lëvizjen tonë, por edhe atë të librit. E them këtë, ngaqë mendoj se ne ende nuk kemi bërë ndonjë radhitje të duhur të



vlerave letrare në raftet e bibliotekës sonë kombëtare, apo mos them se ende nuk e kemi përfunduar periudhën e njohjes së ndërsjelltë e që do bënte që, për shembull, veprat e tregimtarit të patejkalueshëm Anton Pashku, t'i gjesh në Tiranë ashtu siç i gjen librat e cilitdo krijuesi nga Shqipëria në Prishtinë e Shkup.

Mbase kjo edhe na pengon të bëjmë ndonjë vlerësim të qëndrueshëm e të shohim më qartë se ku qëndrojmë përballë të tjerëve, sa i përket letërsisë sonë kombëtare. Duke mos i pasur të gjitha vlerat në një bibliotekë të përbashkët kombëtare, edhe atë sipas një vlerësimi të mirëfilltë me standarde

artistike, ne dukemi si ata që nuk e dinë se letërsia është punë individuale, por në personalen e cilitdo krijues, bënë pjesë edhe përkatësia e tij etnike. Pra, dukemi si ata që nuk e kuptojmë se shumësia e individualiteteve krijuese është thesari artistik që i takon tërë një populli. Jo pse jam unë shkrimtar, por i bindur se e them të vërtetën, mendoj se, nëse populli shqiptar ka ndonjë pasuri me të cilën duhet të mburret, e të cilën nuk mund t'ia mohojë askush, janë vlerat artistike, ndër të cilat ato letrare mbase qëndrojnë më lart se gjitha të tjerat. Pra, vargmali letrar shqiptar, me majat dhe fushënalat e veta, është aq i madh sa u ngjanë alpeve, të

cilave ua kanë zili edhe popujt numerikisht me të mëdhenj se ne, përfshi këtu edhe ata të Ballkanit.

Pastaj arti nuk shkon përpara sipas planeve dhe dëshirave. Ajo që sot duhet të na brengos kur bëhet fjalë për letërsinë tonë, nuk ka të bëjë me vlerat që kemi, por me sistemin vlerësues, i cili mbase është edhe para shkatërrimit të plotë, gjë që mund ta dëmtojë letërsinë tonë. Letërsinë tonë do e dëmtojë edhe moskujdesi ndaj shkrimtarëve të rinj, moskujdes që na solli deri këtu ku jemi sot, kur libra botohen më shumë se kurdoherë më parë, por si asnjëherë deri më tani pa pasur zëra të rinj dhe freski në sferën letrare. Andaj mua nuk më shqetëson ajo se ku qëndrojmë në krahasim me të tjerët, por ku qëndrojmë në krahasim me vetveten. Kur i vlerësoj rrethanat nga ky këndvështrim, them se në krahasim me atë që ishim dhe atë që jemi, edhe në letërsi, shenjë njohëse kemi atë që i dallon lëmitë e tjera shqiptare: të pakujdesshëm ndaj vetvetes dhe ndaj asaj që e portretin një popull, sa i përket pjekurisë së tij kolektive! Pjekurisë së një popull që e ka kuptuar se arti dhe kulturat në përgjithësi japin e marrin nga njëra-tjetra, por vetëm atëherë kur kanë mburojën prej ari, e cila i ka shenjat vetjake njohëse, shenja nëpërmjet të cilave e legjitimojmë vetveten, me të cilat të tjerëve u dëshmojmë se jemi ata që prezantohemi. Në këtë rrafsh e shoh edhe individualitetin krijues brenda një letërsie dhe tërësinë e vlerave letrare të popullit tonë!

Si është raporti juaj me lexuesin në Shqipëri, ju lexojnë më shumë në Tiranë apo në Shkup dhe Prishtinë?

Kim Mehmeti: E kam përsëritur shpeshherë atë që nga pak i irriton shqiptarët e mi të Maqedonisë: në Tiranë e në Prishtinë ndjehem e më njohin si krijues. E këtu në Maqedoni, si "i shtëpisë" që jam, e të cilin mbase "shtëpiarët" e njohin më mirë dhe e dine se "nuk vlen gjë", më shumë më mbajnë si të atillë që turbullon

ujërat politike, se sa si shkrimtar që mundohet të qartësojë botën e vet letrare. Kur e them këtë, nuk akuzoj askënd, as dua që bashkëkombësit e mi këtu në Maqedoni t'i shpalli më pak dashamirës të librit se ata në Prishtinë e Tiranë, ngaqë e di se këtu u bë çmos që ne të mbetemi sa më larg librit, posaçërisht sa më larg librit të autorëve shqiptarë.

Pra, kam përshtypjen se veprat e mia letrare më shumë lexohen në Kosovë e Shqipëri, se sa këtu ku jetoj. Ku ta dish, ndoshta kjo vjen nga shkak se në Shqipëri dhe Kosovë ka lexues që përpos gazetave, lexojnë edhe libra, që nuk duan të jenë vetëm të informuar, por edhe të formuar si lexues, që shkojnë më thellë në të kuptuarit e urtësive jetësore. Por, unë ndjehem mire edhe në 'shtëpi' edhe në Tiranën 'mendjemadhe' e Prishtinën 'arrogante', ku sado pak, janë të pranishme veprat e mia letrare. Ndjehem mire që më lexojnë në të gjitha hapësirat shqiptare! Pra, ndjehem mire që veprat e mia më bëjnë t'u takojë gjitha "Shqipërive" të mia dhe në mënyrë të barabartë ato të më takojnë edhe mua.

Sa afër botës akademike jeni dhe cili është opinioni juaj në lidhje me të rinjtë shqiptarë që diplomohen në ditët e sotme?

Kim Mehmeti: Jam shumë larg botës akademike për shumë arsye, përfshi edhe shkallën e arsimimit tim. Por nga ana tjetër, jam shumë pranë saj, si prind i interesuar për rrethanat dhe kushtet në të cilat arsimohen fëmijët e tij. Dhe mendoj se në kohët e sotme bëjmë një krim që do e paguajmë shumë shtrenjtë: prodhojmë të shkolluar, por të paditur! E bëjmë këtë krim, ngaqë paraprakisht bëme diçka që nuk e lejojnë popujt që e dinë se boshtin e tyre kurrizor e forcojnë të rinjtë e shkolluar. Pra, që e dinë se investimi më i mirë e më frytdhënës që mund ta bëjë një popull është arsimimi cilësorë i të rinjve. Por, ne sot jetojmë kohën kur universitetet u bënë si qendra tregtare, ku blen atë që don

dhe aq sa para ke në xhep. Ne erdhëm deri në shkallën e verifikimit të diturisë jo sipas asaj që ke në kokë, por nëpërmjet thellësisë së xhepit dhe dëgjueshmërisë ndaj nënës parti në pushtet. Andaj kam frikë se do mund të na ndodh të bëhemi popull më i arsimuar në botë, por edhe më inferiori ndaj të tjerëve, kur është në pyetje dituria. Kështu që besoj se ka ardhur koha kur duhet thënë: mjaft më doktoruam, le të mësojmë pak, mjaft më morëm diploma fakultetesh, le të ulemi e të vjelim edhe dituri!

Sa i përket kësaj, ne shqiptarët e Maqedonisë qendrojmë edhe më keq se gjithë të tjerët të botës akademike mbarëshqiptare. Ne lejuam që partitë të vendosin edhe për pastruesit nëpër fakultete, e jo më për ligjëruesit e drejtuesit e tyre. Kështu që sot, ne kemi universitete ku pjesa dërmuese e ligjëruesve, për nga dituria, janë më poshtë se studentët e tyre. Dhe nga profesorët e tillë duhet pritur të lënë pas vetes trashëgimtarë si vetvetja: ligjërues arrogant ndaj studentit të ditur, ngaqë vetëm me arrogancë mund ta mbulojnë boshllëkun që kanë në kokë. E kam thënë dhe do e them: shoqëritë shqiptare nuk i rrezikon as mosfunksionimi i institucioneve, as korrupsioni institucional, sa degradimi dhe shkatërrimi i sistemit vlerësues arsimor, sa devaluimi i diturisë si vlerë përcaktuese që i dallon individët mes veti. Përderisa në mjediset tona libereza partiake është "diploma" më e vlerëshme, kot e kemi të flasim për sistem të shëndosh arsimor. Dhe përderisa thellësia e xhepit ta përcakton "kapelën" arsimore me të cilën do e mbulosh kokën e zbrazur, ne do prodhojmë të rinj të diplomuar, por që do ndjehen inferior ndaj moshatarëve të tyre të popujve fqinjë, bëjnë qindra "të zeza", por nuk lejuan që universitetet e tyre të ngjanë në vetëshërbim ku hyn dhe e blen diplomën vetëm sa për ta përdorur atë si jorgan me të cilën do e mbulosh injorancën.

Ju jeni i angazhuar aktivisht edhe në gazetari. Drejtoni zyrën e një prej televizioneve kryesore shqiptare në

Shkup. Jeni mjaft aktiv me intervistat, me analizat, me komentet tuaja në median shqiptare por edhe në atë maqedonase. Si arrini të ndani kohën tuaj mes gazetarisë dhe letërsisë? Ku ndahen dhe ku bashkohen gazetaria dhe letërsia?

Kim Mehmeti: Mes gazetarit dhe letrarit në mua kam ngritur një mur të lartë, që ata të mos shihen me njëri-tjetrin, e le më të kontaktojnë e të debatojnë mes veti. Por, për çdo ditë i ndjejë orvatjet e publicistit dhe shkrimtarit në mua si mundohen ta rrënojnë këtë mur. Besoj se ende nuk ia kanë dal të bëjnë një gjë të tillë. Unë jam letrar, por që i pëlqen të jetojë edhe me barrën që i takon njeriut publik, të cilit sadopak dikush i beson kur shpreh mendimin e vet lidhur me proceset dhe dukuritë në shoqëritë tona. Ajo që e bashkon letrarit dhe publicistin në mua, është vetëm emblema vetjake. Ndjehem i nderuar që jam pjesë e një projekti mbarëkombëtarë (mbase i vetmi si i tillë), që i përfaqëson mirë shqiptarët kudo që janë, siç është televizioni "Top-Channel". Pastaj i jam mirënjohës pronarit të ndjerë të këtij televizioni, Dritan Hoxhës dhe drejtuesve të këtij televizioni, që më mundësuan diçka që e kisha ëndërruar me vite: të mbroj edhe shkrimtarin edhe publicistin, pa i detyruar ata të përkulen përpara ndonjë tempulli partiak për të mbijetuar materialisht. Kjo është gjëja më e shtrenjtë që më është dhuruar, e për çka do u jem mirënjohës sa të jem gjallë, pavarësisht nga rrugët e mëtejme të jetës sime.

Sa i përket asaj se si e ndajnë kohën mes veti shkrimtari dhe publicisti në mua, mund të them se ata dy janë në grindje të përjetshme mes veti. Por, unë dua të jetoj shpejtë dhe në paqe me vetveten, andaj kur më rrëmben vala krijuese, fare nuk e ndjej mungesën e publicistit në mua, që shfrytëzon "pushimin" e merituar. E njëjta gjë ndodhë edhe kur merr vull publicisti. Krijuesi në mua tërhiqet duke ia lënë të gjitha në dorë publicistit. Kuptohet, tërë kohën duhet mbajtur llogari për atë që e

thash më lartë: që shkrimtari dhe publicisti në mua të mos ndërhyjnë në hapësirën e njëri-tjetrit, gjë që nuk arrihet lehtë, por nuk është e pamundur të realizohet.

Mua më mjafton koha që kam që ta ndjej vetveten të realizuar edhe si shkrimtar edhe si publicist. Madje me mbetet kohë edhe për vetveten dhe të dashurit e mi. Duke e ditur se kohën e harxhuar mund ta shpagojnë vetëm ato që lë pas vetes, mundohem që të jetojë sa më ngutshëm dhe jetën ta kem sa më të pasur me lëngjet që ofron ajo, kështu që në fund të saj të mund të them: nuk jetova kot dhe nuk është se nuk e kam arsyetuar lindjen.

Pastaj, jetoj sipas bindjes se jeta nuk matet sipas kohëgjatësisë së saj, por sipas përmbajtjes që ka ajo. Kuptohet, gjithmonë jam kujdesur që të mos jetoj vetëm për të punuar, por të punoj edhe për të jetuar. Mund të them se deri më tani kam punuar aq sa mos ta dëmtojë shijimin e jetës, dhe kam punuar aq sa mos u ngjaj atyre që mosafhtësitë e veta për të bërë diçka të vlefshme i mbulojnë me mospasjen kohë.

Z. Mehmeti ju jeni gjithashtu mjaft aktiv edhe në "median online". Keni një llogari mjaft aktive në facebook, si dhe një faqe interneti mjaft të pasur. Cili është opinionin tuaj në lidhje me atë që cilësohet si media e gjeneratës së re?

Kim Mehmeti: I shfrytëzoj edhe mundësitë që ofrojnë mediat e gjeneratës së re, edhe pse i takoj gjeneratës, e cila kurrë nuk do i besoj ekranit të kompjuterit aq sa fletës së bardhë. Mediat elektronike fillova t'i shfrytëzoj i nxitur dhe i ndihmuar nga fëmijët e mi, të cilët bien në gjumë me laptopin në prehër, e zgjohen me telefoni celular në dorë, që të shohin se kush çka u ka thënë, përderisa ata kanë qenë në gjumë. Nuk kam si të jetojë jashtë kësaj kohe, kur interneti na i mori edhe fëmijët dhe ata komunikojnë me tërë botën, por duke e shmangur bisedën me familjarët e vet, duke harruar se shtëpia nuk është bujtinë ku e kalon vetëm natën, e të cilën

babai e furnizon e nëna e mirëmban, por edhe fole që komunikon me gjuhën e ngrohtë të gjakut familjar. Por realitetit nuk i iket. Dhe do ishte e pakuptim të mundohesh të dalësh jashtë kohës dhe jashtë realitetit që të rrethon. Andaj edhe dua t'i shfrytëzoj mundësitë që i ofron interneti.

Fëmijët e mi dhe disa miq të tyre, hapën një faqe timen në internet si dhe një *fan page* në *facebook*, numri i të cilëve ka arritur në mbi dyzet mijë veta. Dhe në njëfarë mënyre, ata janë "dhunuesit" që më çuan të jem më aktivë në këto faqe, duke më përballur me përgjegjësinë që nuk e prisja: me vetëdijen se të përcjellin e lexojnë me dhjetëra mi, kryesisht të rinj. Herë pas here, edhe vetë kujdesem për këto faqe dhe jam bindur se rrjetet sociale, si *facebook*-u, sot janë mediat më të fortë e më me ndikim se cilat do media të tjera. Ja një shembull: çdo postim i imi në FB, brenda dhjetë minutash lexohet nga më shumë se 10.000 lexues! Cila gazetë, për shembull, mund të ta ofrojë këtë lexueshmëri! Mua nga pak edhe më frikon ky ndikim që kanë rrjetet sociale te gjeneratat e reja, sepse pos të mirave, nëpër to ka edhe përplot destruktivitet e sharje mes debatuesve. Më tremb kjo, sepse ka rrezik që ky destruktivitet ta helmojë më të vlefshmen që kemi: rininë! Andaj nuk jam ithtar i "robërisë" moderne, të cilës ngadalë i nënshtrohem të gjithë.

Si e gjykoni çështjen e pajtimit të shqiptarëve dhe serbëve, a mendoni se ky është opsioni i mundshëm për këtë rajon?

Kim Mehmeti: Ne nuk mundet përjetë të mbetemi të armiqësuar me cilindo popull fqinj, por duhet përjetësisht të kujtojmë atë që na e kanë bërë ata. Ne nuk kemi mundësi t'i zgjedhim fqinjët e as t'i ndryshojmë ata që jetojnë pranë nesh, por mund ta ndryshojmë vetveten dhe si shtëpiarë të mirë, të bëjmë çmos që t'i njohim fqinjët sa më mirë, me çka do e kemi më lehtë ta përcaktojmë se si

duhet të sillemi ndaj tyre. Dhe shikuar nga ky këndvështrim, ne duhet ta kuptojmë një gjë: në këtë Ballkan jemi popull i vetmuar, të cilin e rrethojnë familje kushërinjsh e vëllezërisht, të cilët herë-herë edhe grinden për shumëçka mes veti, por kur jemi ne në pyetje, ata të gjithë pajtohen se jemi "i gjakut" tjetër. Pra, duhet pasur kujdes se jetojmë në këtë Ballkan, ku çdo gjë ndryshon e ecë përpara, por jo edhe mendësia ëndërrimtare e popujve të këtushëm të vegjël që ëndërrojnë shtete të mëdha. Dhe se kjo mendësi edhe gjatë kohë do jetë përcaktuese për fatet e popujve të këtushëm. Kjo duhet të na bëjë të kujdesshëm ndaj fqinjëve e ndaj vetvetes. Ky kujdes do na mundësojë të kuptojmë se ëndrrat e tyre ndaj nesh do varen nga ëndrra jonë për një gjuhë, një flamur, një komb e një shtet! Andaj, ne duhet të tregohemi ëndërrues që nuk e tradhetojnë ëndrrën, deri sa atë ta jetësojmë. Por, të jemi të vetëdijshëm se ëndërrojmë ne, por ëndërrojnë edhe ata rreth nesh. Si dhe të jemi të vetëdijshëm se kur përballen ëndrrat, mund të ndodh që të shëmbet e ardhmja.

Me këtë vetëdije në vetvete, ne nuk duhet të prodhojmë armiq, por fqinj që na mirëkuptojnë. Dhe duke e ditur se nuk mund ta ndryshojmë as mikun e as armikun, neve duhet të na mjaftojë që ata t'i njohim mirë dhe të mos lejojmë befasira. Ne më së keqi kemi kaluar kur kemi besuar se ndonjë nga fqinjët e kemi aq dashamirës sa atij të mund t'ia lësh çelësin e shtëpisë, pa u brengosur se ai do mund ta keqpërdorë besimin. Andaj edhe na ka ndodhur që miqësia me fqinjë të përfundojë në armiqësi të përjetshme. Që të mos na përsëritet e kaluara, ne me fqinjët duhet të ndërtojmë marrëdhënie që nuk do kenë shenjë njohëse as miqësinë joracionale, as armiqësinë irracionale, por që do e përcaktojnë vetëdija se fqinji të bënë atë që t'i ia lejon, se ai e përdor oborrin tënd nëse nuk e ke thurur mirë dhe se, fqinji ndërhyr dhe e nxitë grindjen mes familjarëve tu, vetëm kur e vëren se nuk të shkojnë punët mirë brenda familjes.

Më në fund, nuk ka fqinj që nuk do donte oborrit të vet t'ia bashkëngjiste edhe atë të shtëpisë fqinje, por nga ana tjetër, nuk ka shtëpiar që më shumë do i besonte fqinjit, se sa familjarëve të vet. E ne shpesh jemi marrë me "armiqtë" brenda familjes, pa e vërejtur se kush na i ka sjellë "mbeturinat" në oborr, e shkak i të cilave grindemi. Shkurt: ne duhet të jetojmë në paqe me vetveten e në harmoni me fqinjët tanë, por edhe të bindur se edhe armiku mund ta marr nga ti vetëm aq dhe atë që nuk je i aftë ta mbrosh.

Si do ta vlerësonit rolin e Shqipërisë në raport me shqiptarët që jetojnë në Kosovë, Maqedoni dhe në rajonet e tjera të Ballkanit. A mendoni se janë dakord bashkatdhetarët tanë jashtë kufijve zyrtarë të shtetit shqiptar që të pranojnë një rol kujdestarie nga ana e Shqipërisë, sepse sot ka nga ata që janë kundër kësaj, madje flitet edhe për identitetin kosovar.

Kim Mehmeti: Të flasësh sot për identitet të ri të shqiptarëve të Kosovës, është njësoj si të thuash se fëmijët kosovarë vetë e shpikin gjuhën shqipe në të cilën flasin dhe atë nuk e kanë mësuar nga të parët e vet. Pastaj, të trillosh identitet të ri kosovar, do të thotë të shkelësh mbi gjakun dhe ëndrrat e gjeneratave që flijuan çdo gjë për ta mbrojtur identitetin tonë shqiptarë. Të heqësh dorë nga identiteti i mbijetuar gjatë shekujve, e të shpallësh "rilindës" i një identiteti të ri, do të thotë se je bërë rob i mendësisë së kryeministrit maqedonas Gruevski, por vetëm e kthyer mbrapsht: ai mundohet t'i lidh degët e popullit maqedonas edhe me rrënjë të trilluara, e "rilindësit" e identitet të ri kosovar duan t'i ndajnë degët e populli tonë në Kosovë nga trugu dhe rrënjët shqiptare.

Si do që të jetë, Shqipëria është ajo që na dha dhe na e mbrojt emrin dhe e tillë siç ishte, mbeti djep që mëkoi ëndrrën shekullore të shqiptarisë. Pra, Shqipëria ndërthen në vetvete ëndrrën

mbarëshqiptare për të pasur edhe ata shtet të vetin. Shqipëria është "fëmijë" i lindur me mangësi trupore, por edhe si e tillë, ajo ishte fole e ngrohtë edhe për ëndrrat e shqiptarëve që mbetën jashtë kufijve të saj. Madje mos ishte Shqipëria, shumë më vështirë do mbijetonte Shqiptaria.

Dhe sot kur kemi dy shtete shqiptare, nuk duhet harruar se njësoj si Shqipëria dikur, edhe Kosova u bë shtet ngaqë ishte ëndërr mbarëshqiptare, e jo vetëm e kosovarëve. Dhe për themelimin e këtyre dy shteteve tona, kontribuan shqiptarët e të gjitha trojeve etnike. Ato dy shtete që kemi sot, kurrë nuk do ishin ata që janë, nëse Shqipëria nuk do na e ruante emrin dhe nëse Kosova nuk do na e ushqente ëndrrën për çlirim të të gjitha trojeve tona. Sot ajo ëndërr duhet të vazhdojë të kultivojë vetëdijen se Shqipëria është deri aty ku ka shqiptarë, por duke u kujdesur të mos na robëroj mendësia serbe, e cila i ka më të vlefshme kishat dhe tokat, se sa njerëzit e që e solli aty ku ndodhet sot: të ketë histori përplot me beteja të humbura dhe me shumë "djepe" ku mëkohet mitologjia që të lë pa të ardhme. Sot boshtin kurrizor duhet ta forcojmë nëpërmjet gërshetimit të vëmendjes të asaj që na ka ndodhur në të kaluarën, me mjeshtërinë që pagabueshëm t'i hapim rrugët drejt të ardhmes. Pra duhet të kujtojmë "Çamëritë" tona, si parakusht që ato të mos na përsëriten.

Dhe shikuar nga ky këndvështrim, Tirana ishte dhe duhet të mbetet flakadani që përcakton ecjen tonë kolektive. Pra, Shqipëria duhet të jetë ajo ombrellë që të gjithë shqiptarët jashtë kufijve të mëmëdheut, do i bëjë ta ndejnë hijen e saj. Shkurt, se cili do të jetë fati ynë kolektivë varet nga gjitha "Shqipëritë" tona, por duhet ecur përpara ashtu siç i takon një familjeje të kujdesshme ndaj vetvetes, e cila edhe mund të udhëtojë drejtë së ardhmes në vagonë të ndryshëm, por duke e ditur se bashkërishtë duhet ta mirëmbajmë lokomotivën dhe të vetëdijshëm se edhe kur ke dy lokomotiva, ato duhet bashkërisht ta çojnë trenin

përpara, e jo të mos dallohet ku është bishti e ku koka.

Si i vlerësoni qëndrimet se "shqiptarët kanë atë udhëheqje që meritojnë" ?

Kim Mehmeti: Asnjë popull nuk meriton të ketë prijës të këqij. Por është e vërtet se nëpërmjet udhëheqësve që ka, mund ta përcaktosh edhe vetëdijen dominante politike të atij populli. Andaj nuk është e rastit që i kemi drejtuesit të atillë siç i kemi. Thjeshtë, gjatë zgjedhjeve, votuesi nuk e vulosë vetëm besimin e tij ndaj kandidatit, por edhe standardet e veta vlerësuese. Pastaj, kur rrënohet një sistem shoqëror, së bashku me të, rrënohen edhe standardet e vjetra vlerësuese dhe rëndomë, në sipërfaqen politike, nuk dalin më të urtit, por më të ngutshmit e më të guximshmit. E ngutja e guximi shpeshherë nuk kanë të bëjnë gjithaq me vetëdijen, sa me instinktin. Dhe ndodh që gjatë periudhave të këtitla, të mos mund ta dallosh të ndershmin nga i pafytyri, bardin nga maskarai...., diçka që është duke ndodhur sot nëpër shoqëritë shqiptare. Në rrethana të tilla, thujse çdo gjë e mbulon mjegulla e ngutjes, hutesës dhe paqartësisë, mjegull që të gjithë i shndërron në hije të paqarta, që të duken të gjitha njësoj, andaj edhe vështirë e ka populli të dallojë fytyrat e vërteta të atyre që kanë dalë në krye të kolonave. Dhe në kohë të tilla, nuk mund të flitet vetëm për politikanë të këqij e të mirë, por flitet edhe sa janë të shëndosha elitat tona shkencore, kulturore.... Nga kjo mjegull, ne nuk ia arrijmë të dalim, jo vetëm pse kemi politikanë të korruptuar e të paafte, por pse të gjithë nga pakë u korruptuam. Gjithashtu, ne kemi edhe elita të paafte, të cilave u përshtatet t'i mbulojë mjegulla e paqartësive. Populli legjitimohet nëpërmjet elitave që ka. Kur flitet për popullin, mendohet se këto elita e kompletojnë letërnjoftimin e tij.

Cili është opinioni juaj për marrëveshjet e fundit që Kosova po nënshkruan me Serbinë? A ju duket se shqiptarët janë të vetmit që lëshojnë pe në negociata?

Kim Mehmeti: Jo sot, por e besoj gjithmonë gjatë së kaluarës, se ashtu do jetë edhe në të ardhmen. Fatin e popujve të vegjël nuk e përcakton e drejta që ka ai, por ajo se sa atë të drejtë e përkrahin qendrat ku arnohen dhe definohen hartat e shteteve që e përbëjnë shumësinë e kësaj bote, por që nuk luajnë asnjë rol vendimmarrës për rrjedhat globale. Andaj edhe marrëveshjen mes Kosovës e Serbisë, duhet parë nga ky këndvështrim. Elefanti kurrë nuk e pyet milingonën ku ta vë këmbën, andaj milingonat e mençura ngandonjëherë ngjiten mbi shpinën e elefantit dhe hapin rrugë të paimagjinueshme krahasuar me përmasën e tyre. Sot jetohej e mbijetohej sipas filozofisë se vlen aq sa ke të mëdhenj, të cilët kanë respekt ndaj vogëlsisë tënde dhe të drejtave që ke. Gabimin më të madh që mund ta bëjnë popujt e vegjël është të besojnë se kudoqoftë, të fuqishmit janë mbështetur mbi të drejtat e popujve të vegjël. Pra, më e vlefshme se të gjitha është të vlerësosh drejtë rrethanat në të cilat vepron. Por kuptohet, edhe milingonës së rrethuar nga të gjitha anët me shputat e elefantëve, një ditë i mërzitet jeta dhe thotë: më mirë të mos jem fare, se sa të jetojë me frikën se do përfundoj e shkelur dhe fillon t'i bezdisë të mëdhenjtë që nuk e përfillojnë! Dua të them se çdo gjë duhet mbrojtur dinjitetshëm, sepse ka një vijë përtej së cilës je i vdekur edhe kur merr frymë. Pra ka një kufij përtej të cilit nuk shkohet, ngaqë nuk të vlen as shteti e as pushteti.

Mendoj se qeveritaret aktual të Kosovës janë duke ecur drejt këtij kufiri. E them këtë sepse serbi e ka për qëllim, (dhe deri më tani mirë i shkojnë punët) që brenda Kosovës të lërë një Serbi të vogël. Kjo të bënë shtet, që gjithmonë

do jesh i varur nga një armik shekullor. Nëse pushtetarët e sotëm veprojnë sipas parimit “merr ç’të duash, por vetëm më lërë në pushtet”, kjo do të jetë edhe një nga përjetimet tona nga e kaluara, kur prijësit tanë më me rëndësi donin të mbeteshin në pushtet, më shumë se sa të mbronin shtetin dhe popullin që përfaqësojnë. Shpeshherë kam përshtypjen se edhe Hashim Thaçi vepron sipas parimit: Interesi i shteti dhe i popullit, është i barabartë me atë timin për të mbetur sa më gjatë në pushtet! Shpesh them për shkak të përshtypjeve sime: shyqyr Zotit që Kosova ka një Albin Kurti, që bënë shumëçka. Edhe kur nuk më pëlqen, gjithsesi, ai palodhshëm i frynë zjarrit që duhet mbajtur gjithmonë kallur: atë për bashkim kombëtar. Të mos e paguajmë formimin e “Shqipërive” tona të reja, duke e paguar këtë me rruhdjen e tokave shqiptare. Kjo gjë ka ndodhur gjithmonë në të kaluarën.

Në këto “Shqipëritë tona”, ashtu siç i cilësoni ju, flitet çdo ditë për integritimin dhe bashkimin me Europën. Nga ana tjetër, ky bashkim po duket gjithnjë e më larg. A mendoni se shqiptarët po ecin drejt integritit me kosto shumë më të lartë se të tjerët?

Kim Mehmeti: Sipas meje, shqiptarët kudo që janë bëjnë një gabim: duan të bëhen pjesë e Evropës së bashkuar, por me mendësi të copëzuar në vetvete dhe me plot mure mendore. Shihni për shembull veprimin e kryetarit të BDI-së në Maqedoni: merret me diplomaci rajonale e botërore, angazhohet të ndihmojë në zgjidhjen e problemit mbi emrin që ka Maqedonia, don të na çojë në Evropën pa kufij, por ndërkohë, qeveria ku bënë pjesë partia e tij e bllokoi kufirin me Kosovën, i bllokoi kufijtë shqiptaro-shqiptar. Andaj ngandonjëherë më bëhet se këta prijësit e “Shqipërive” tona, duke u ndje inferior ndaj burrështetasve të vendeve fqinje, tërë forcën e vet ia tregojnë njëri-tjetrit, si edhe ndjehen të fuqishëm kur e gjunjëzojnë popullin e vet. Dhe këtë bindje timen e

mbështes edhe në diçka edhe më të dhimbshme që na ndodh neve shqiptarëve të Maqedonisë: pushtetarët tanë shqiptarë më shumë e mbrojnë sunduesin maqedonas nga ne që e krijojmë atë, se sa neve nga trysnia që na e bënë ky regjim. Çka për mua e shpalos mendësinë vasale, e cila nuk mund të jetë mendësi evropiane e as civilizuese. Pastaj ne duam të shkojmë në Evropën e bashkuar ende pa e përfunduar debatin se cili është interes yni mbarëkombëtarë, të cilin mund ta realizojmë edhe nëse mbetemi si vëllazëri që jeton në më shumë shtëpi të ndara mes veti.

A janë sot shqiptarët një komb i plotësuar në aspiratat e tyre?

Kim Mehmeti: Ne sot jemi një popull që e dinë çka synon, por që ka drejtues të cilët kanë vetëm një ambicie: çdonjëri të ketë “Shqipërinë” e vet. Andaj ne si popull i ngjamë atij që e dinë ku duhet të arrijë, por ndjehet si i parrugë. Duhet thënë se me mëvetësimin e Kosovës, ne realizuam një nga aspiratat më të mëdha pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Besoj se e jetojmë shekullin që do na takojë neve. Por gjithashtu, e di se çdo gjë do varet nga ne dhe nga rirreshtimi që duhet bërë sa më shpejtë.

“Islami e ka shpëtuar shqiptarinë”. Është kjo një fjali e juaja për të cilën jeni kritikuar nga një grup, por edhe jeni përkrahur masivisht nga një pjesë tjetër. Çfarë do të thotë kjo, si ndodhi ky proces?

Kim Mehmeti: Nuk e mbajë vetveten për shumë të ditur, por jo edhe për aq çmendurak sa të them diçka që në mos më shumë, kërkon shpjegim se kush i ka shpëtuar shqiptarët e krishterë. Kam thënë atë që do e them gjithmonë: se në rrethana të caktuara, brenda një periudhe kohore, në një hapësirë të caktuar, brenda një kolektiviteti me vetëdije të ulët kombëtare (siç ka qenë dikur Shkupi e rrethina e tij), edhe religjionet kanë luajtur

rol përcaktues për mbrojtjen e përkatësisë etnike. E kam thënë me gojë e shkrim, e do e them gjithmonë: gjatë periudhës të socializmit, kur neve shqiptarëve të Maqedonisë na lejohej të kishim “mektebe” ku e mësonim alfabetin arab, por jo edhe shkolla në gjuhën shqipe, kur ne rriteshim duke mos dëgjuar gjë as për Fishtën e as për Skënderbeun, ajo që na bënte të dallueshëm nga “shkijet” (lexo: sllavët e jugut), ishte vetëm gjuha dhe përkatësia jonë fetare. Pra, në Maqedoni, nuk do ishim as kaq sa jemi, sikur të mos ishin ato nënat tona që jetuan të mbyllura mes avllive, që ëndërronin vetëm të ardhmen tonë dhe të cilat e ruajtën gjuhën shqipe. Ne mbetëm kaq sa jemi, ngaqë feja islame ishte ajo që gjithashtu, gjatë periudhës së socializmit, na ndihmoi të mos bëhemi “shkije” e të dallojmë nga ata që nuk na donin. Edhe atë jo pse ishim mysliman, por pse ishim shqiptarë, gjë që i çonte të bëjnë çmos që të harrojmë përkatësinë etnike dhe të mbajmë mend vetëm atë religjiozen. Por, betejën e fituam ne, e fituan nënat tona, që bënin luftë të dyfishtë: na e mbronin gjuhën që ishte i vetmi atdhe që na kishte mbetur dhe na i mësonin lutjet që ia drejtonim Zotit, me çka mbetëm edhe bijë të kombit edhe fëmijë të Allahut. Andaj nënat tona, e jo ne të sotmit, janë ato heroina legjendare që e fituan betejën kundër asimilimit tonë. Pra, ato e ruajtën edhe përkatësinë tonë etnike, edhe atë fetare. Gjë që nuk ndodhi me shumicën e shqiptarëve të krishterë katolik e ortodoksë nga këto hapësira, të cilët gjatë periudhës së socializmit, për të mbrojtur fenë e tyre, e dhanë gjuhën dhe përkatësinë etnike. Dhe kur e them këtë, unë nuk dua të akuzojë as ndonjë fe, as ndonjë shqiptar, ngaqë e di se asnjë fe nuk e ka për detyrim mbrojtjen e përkatësisë etnike, por atë fetare. Por unë flas për rrethana dhe kohë konkrete. Flas për rrethana kur shumëçka funksiononte “jonatyrshëm”. Kur flas për këto tema të ndjeshme, unë nuk merrem me peshimin e asaj se vallë kryqi apo çerekhëna gllabëruan më shumë shqiptarë, por

konstatoj se qindra mijë shqiptarët që u shpërngulën në Turqi, nuk i shkëputën rrënjët as me popullin, as me trevat nga shkuan, por edhe sot thonë jemi “arnaut”. Unë vetëm konstatoj se pjesa më e madhe e shqiptarëve të krishterë nga këto hapësira, e të cilët lejuan që fëmijët e tyre ta harrojnë gjuhën e përkatësinë etnike, sot më janë shkëputur plotësisht nga rrënjët dhe trangu kombëtar. Ka ndonjë që mund ta dëshmojë të kundërtën, sa i përket kohës për të cilën flas dhe sa i përket hapësirës për të cilën kam shkruar në librin tim “Shkupi”? Nëse ka, pse të tillët merren me debate përjashtuese, e nuk marrin të shkruajnë një libër, ku do dëshmojnë se nuk është i vërtet konstatimi se gjuha dhe përkatësia jonë fetare islame, ishin ato që na mbrojtën nga asimilimi i tërësishtëm dhe na mundësuan ta mbijetojmë periudhën shkatërrimtare të socializmit. Me çka edhe arritëm deri këtu ku jemi sot: mburremi dhe ndjehemi si pjesë e vëllazërisë shqiptare shumëfetare, shumëdialektore, por që frymon, mendon e flet vetëm shqip.

Ju shfaqeni shpesh si kritik i politikanëve shqiptarë në Maqedoni. Keni kritikuar për vasalitet ndaj maqedonasve, si PDSH-në ashtu edhe BDI-në. A mendoni se shqiptarët në Maqedoni janë të dënuar të zgjedhin një prej dy këtyre alternativave? Sa mundësi ka që kjo situatë të ndryshojë?

Kim Mehmeti: Problemi i organizimit politik të shqiptarët e Maqedonisë është shumë më i thellë e më i ndërlikuar se sa sjellja e dy partive më të mëdha që ata kanë. Por, ai më së lehti, mund të shpjegohet vetëm nëpërmjet veprimit politik të këtyre dy partive. Pra, problemi është se ata nuk kanë parti të mirëfillta politike, po sekte partiake të kapura nga qarqet e biznesit dhe nga qarqet policore maqedonase. Mendoj se momentalisht as që mund të dilet nga kjo situatë e mjerueshme. duke qenë jashtë “kalasë”, shqiptarët e këtushëm as që mund të shohin e të vlerësojnë drejtë se çka ndodh brenda saj

dhe cilat janë ato qendra, që atyre edhe ua përcaktojnë udhëheqësit politik. Unë nuk mund të quaj askënd as tradhtarë, as më pak atdhetar se unë, por nga ajo që di dhe aq sa jam i informuar, në Maqedoni ende vepohet sipas parimit se “shqiptarë i përshtatshëm për shtetin, është vetëm shqiptari i korruptuar dhe i njollosur!” Më në fund, këtë e kanë pohuar publikisht edhe vetë përfaqësues politik të etnisë maqedonase. Andaj, mendoj se partiakët e këtushëm shqiptarë, nuk e kuptuan, ose shtiren se nuk e kuptojnë, se nuk mund të kesh pushtet pa pasur shtet, se nuk mund të jesh drejtues shteti, kur tjetri e mbanë çelësin e arkës me para, e ty të jep jo aq sa ka nevojë, por aq sa ai mendon se të mjaftojnë! Kështu, te pala maqedonase ka rrënjësor bindjen e gabuar, por që tani për tani funksionon, se nuk ka shqiptarë të cilin nuk mund ta blesh, por vetëm duhet t’ia caktosh çmimin e merituar! Pra, ne shqiptarët e këtushëm përballemi me paradoksin se duke qenë përfaqësuesit tanë vetëm vasal të thjeshtë të partnerit maqedonas që e sundon shtetin, atyre edhe nuk u mbetet gjë tjetër përpos gjërat t’i masin kryesisht me mendësinë e vasalit, nëpërmjet përfitimeve personale. Këto përfitime t’i barazojnë me të mirën e popullit. Sipas meje, situata do mbetet e pandryshuar dhe ajo do ndryshojë atëherë kur shqiptarët e këtushëm do e themelojnë Parlamentin e Shqiptarëve të Maqedonisë, i cili si i barabartë, përfundimisht do dialogojë me Parlamentin maqedonas dhe do e përcaktojnë se si bashkërisht do e drejtojmë këtë “kompani”, për të cilën punojmë të gjithë, por thuajse e tërë “dividenta” i takon palës maqedonase. Por, duhet thënë qartë: situata e tanishme u përshtatet edhe partive shqiptare, ngaqë ajo u mundëson të bëjnë tregti me kërkesat shqiptare, të cilat jo rrallë herë flijohen për përqindjet e marra nga ndonjë tender. Andaj këtu edhe publicistët maqedonas, e jo vetëm disa nga ne shqiptarët, për pushtetarët e këtushëm shqiptarë e përdorin emërtimin “tenderokratë”. Dhe deri sa është kështu, atëherë do

vazhdojë dukuria që pjesëmarrja e partive shqiptare në qeveritë e drejtuar nga pala maqedonase të mos shprehin forcën politike të shqiptarëve të këtushëm, por ta forcojnë partinë maqedonase që drejtojnë koalicionin qeverisës. Dhe do ndodhë që legjitimiteti që ka partia shqiptare për të përfaqësuar popullin e vet, t'i legjitimojë politikant antishqiptare të regjimeve të këtushëm. Siç ndodh, për shembull sot, kur regjimi i Gruevskit, me pesë ministra shqiptarë të BDI-së bllokoi kufirin me Kosovën, realizoi projektin "Shkupi 2014". Botoi enciklopedi antishqiptare, duke i financuar edhe me paratë e taksapaguesve shqiptarë. Unë ende mbroj qëndrimin se kështu siç është sot, shqiptarët e këtushëm, ndoshta do kalonin më mirë pa pasur përfaqësues të vet në qeveri, se sa kur kanë pesë ministra dhe almet zëvendësministrash. Do pyetni pse?! Sepse atëherë, qeveria maqedonase nuk do kishte legjitimitet e do ishte nën monitorim të rreptë të ndërkombëtarëve, sepse atëherë deputet shqiptarë do e bllokoi punën e qeverisë, sepse atëherë Maqedonia do mbetej pa qeveri, e do shihej më qartë se kështu nuk bëhet Maqedonia shtet. Sot, kur ke aq përfaqësues shqiptarë në qeverie nëpër institucionet shtetërore, me të drejtë të huajt ma shtrojnë pyetjen: pse dhe kujt i ankoheni ju shqiptarët? Me të vërtetë, pse dhe kujt i ankohemi ne shqiptarët, kur kemi përfaqësues injorant, që nuk dinë të përdorin faktorin politik e 30 përqindëshit, sa jemi në këtë shtet? Këtë pyetje gjithnjë e më shpesh ia shtroj edhe vetvetes! Dhe në vend të përgjigjes, përballim me të vërtetën se Maqedonia është shtet i mirë për pushtetarët shqiptarë që vijnë në pushtet të dobët, kockë e lëkurë dhe e braktisën atë kur janë "të majmë" si derra, por jo edhe për popullin tim i cili gjithnjë e më shumë varfërohet dhe i përcjellë bijtë e vet në vendet perëndimore. Pra, në Maqedoni ndodh ajo që e karakterizonte

Jugosllavinë socialiste. Kur elitat politike ndërtonin mes veti "bashkim-vëllazërim" dhe popujt ndaheshin mes veti, e thellonin hendekun ndarës aq sa pastaj nuk kishte urë që t'i ndërlidhë brigjet e tij. Ku ta dish, mbase me këta leninistët që drejtojnë BDI-në, edhe nuk mund të ndërtohet asgjë tjetër përpos se një shoqëri ku do vlejné parimet e dikurshme: "populli jemi ne dhe ata që nuk e ndjekin rrugën e partisë - siç do të thoshte lideri i kësaj partie - do i djegë prushi i partisë!"

Sa të mundshme e shikoni bashkëjetesën e shqiptarëve me maqedonasit në të ardhmen, duke pasur parasysh dhe përplasjet e fundit me karakter etnik, siç janë sharjet dhe fyerjet ndaj shqiptarëve në stadium, rrahjet e të rinjve shqiptarë dhe incidente të tjera të kësaj natyre?

Kim Mehmeti: Jam rritur, jam shkolluar e kam bashkëpunuar me maqedonasit. Pretendoj se i njoh elitat e këtij populli dhe se e njoh mendësinë e tyre. Shumica e pjesëtarëve të këtyre elitave, janë nxënës të mirë të shkollës antishqiptare beogradase dhe është e vështirë që kjo mendësi të zhbëhet. Andaj shpesh e them: Ne edhe mund të duam shtet të përbashkët me ta, por ata këtë as që mund ta paramendojnë e le më ta pranojnë! Dhe shumëçka e mbështet këtë bindje timen. Gjatë dy dekadave të kaluara, sa më shumë ne kemi shprehur vullnetin për bashkëjetesë, aq më shumë ata nuk na kanë pranuar. Pastaj, asnjë e arrirë e shqiptarëve të këtushëm nuk është realizuar nëpërmjet ndonjë dialogu politik, por gjithmonë në stilin "do e marrësh vetëm kur të më mbështesësh për muri". Pra, të arrirat e shqiptarëve të këtushëm nuk shprehin vullnetin politik të palës maqedonase, por mospasjen rrugë tjetër si dhe presionin e ndërkombëtarëve. Andaj ç'më duhet mu shtëpia ku duhet të jetojë,

me bindjen se do jem i qetë vetëm nëse hyrjen e saj e ruajnë policët ndërkombëtar dhe se fqinji mezi pret të më braktisë nga ajo, apo pjesën time të shtëpisë të ma jep me qira?! Pastaj ndodh edhe një fenomen i çuditshëm: ne shqiptarë jemi të vetmit që maqedonasve nuk u kontestojmë as gjuhë, as etni, sa shtet e ata vazhdojnë të ndjejnë të naltin animozitet ndaj nesh si të ishim ne serbët që ua kontestojnë kishën, apo bullgarët që ua mohojnë thuajse të gjitha, ose grekët që mund të paramendojnë se mund të ketë shtet e popull maqedonase?! Andaj, edhe e kam shtura pyetjen publike: si mund ta kalosh një jetë me atë që hapur të tregon se nuk të don e të ndjen të largët! Nuk e fsheh: jetojë me bindjen se ky shtet kalbet nga brenda se në fund ai do i ngajë arrës që ka lëvozhgën, por me brendi plotësisht të prishur. Jetojë me bindjen se në Ballkan janë formuar edhe shtete që madje nuk meritojnë të kenë kufi. Se një nga ato shtete është edhe Maqedonia!

A ka sipas jush një avancim të rrymës nacionaliste të shqiptarët dhe a është kjo në të mirë të interesave të kombit shqiptar? Përse në Maqedoni nuk shohim lëvizje në këtë drejtim?

Kim Mehmeti: Më gëzon nacionalizmi i kultivuar i viteve të fundit i të rinjve të Shqipërisë, i cili bartë me vete atë krenarinë e pangulfatur nga folk-nacionalizmi dhe nga romantizmi etnik. Dhe dua që diçka e ngjashme ta përfshijë edhe rininë e këtushme shqiptare. Pra, jam për një nacionalizëm që mbështetet mbi vetëdijen se të tjerët të vlerësojnë edhe nëpërmjet asaj se sa ti e çmon dhe je në paqe me vetveten. Te shqiptarët e Maqedonisë, shumëçka duhet vlerësuar pa harruar rrethanat në të cilat është ndërtuar vetëdija e tyre kombëtare dhe cilat janë kushtet e sotme ku ajo vetëdije duhet të mbijetojë. Sot, këtu, kemi një

rini të mrekullueshme, por e cila përjeton thyerje të mëdha, që jeton në pritje se çka do të ndodh me këtë shtet dhe cila është rruga që duhet ndjekur ata. Dhe unë flas për rininë, ngaqë ajo më intereson dhe ajo do përcaktojë rrugëtimin e mëtejshëm tonë kolektiv. Dhe rinia e këtushme shqiptare, ende nuk ka dëgjuar përgjigjen e saktë se për çfarë Maqedonie duhet të angazhohet dhe cili është projekti shqiptar për këtë shtet. Sot, ajo jeton frikën e sulmeve të përditshme nga huliganët maqedonas dhe ndjehet e pambrojtur. Ajo dëgjon brohoritjet e përditshme të tifozëve sportiv maqedonas, të cilët edhe kur kombëtarja e tyre përballet me bullgarët, ata na shajnë neve shqiptarëve. Dhe me të drejtë kjo rini pyet: kush na mbron neve dhe a jemi në shtëpinë tonë, apo banorë në adresë të gabuar?! Ndërkohë, përgjigja dhe mbështetja mungon, gjë që disa nga ata i bënë edhe të gabojnë e të mbështeten në grupe e individë që bëjnë një mëkat antikombëtarë e antifetarë, e «arabizojnë» shoqërinë e shqiptarëve të këtushëm. Apo duan të na bindin se mysliman i mirë është vetëm ai që përqafton me të gjitha edhe traditën arabe.

Pra, sot për sot, rinia e këtushme shqiptare jeton duke u ushqyer me premtimet e mjegullta të partiakëve dhe me paqartësinë pse mëmëdheu i tyre as sesi nuk ia del të etablohet si në një shtet të mirëfilltë demokratik. Edhe pse një Kosovë mbeti e ngulfatur nga korrupsioni dhe destruktiviteti politik. Nuk duhet harruar, se nacionalizmin i shqiptarëve të Maqedonisë, ende i ngjan «korit» që dirigjohet nga Tirana e nga Prishtina. Dhe të mbetur thuajse të pambështetur nga askush, duke u ndje të papërfaqësuar në shtetin ku jetojnë, të rinjtë e këtushëm shqiptarë janë në shënjestrën e partive politike që nuk i çojnë më larg se sa te grazhdi partiak, si dhe janë pre edhe e sekteve të ndryshme fetare, që u japin certifikata për vendin që do u takojë pas

vdekjes, por duke ua mjegulluar rrugët e kësaj bote.

Por e them me plot bindje: duke vlerësuar nëpërmjet kushteve e rrethanave në të cilat jeton dhe vepron rinia e këtushme shqiptare, mund të them se ata janë heronjtë e kohës sonë dhe mbase edhe pjesa më atdhetare mbarëshqiptare. Por nëse edhe më tej, ajo do mbetet në duart e politikanëve të këtushëm të papërgjegjshëm e injorantë, vrulli i saj do venitet e madje, në masë të madhe edhe do mund të deformohet. Posaçërisht, kur arsimimi ka degraduar deri në atë masë sa partia, e jo ajo që ke në kokë, ta përcakton shkallën e diturisë dhe të aftësive individuale. Apo, kemi ardhur deri aty, ku modelet e suksesshme për të riun tanë të jenë «banditët» partiakë dhe shkalla që të ngjitet drejtë suksesit të jetë ajo e «rrugaçerisë partiakë»

Cili është opinioni juaj, në lidhje me rotacionin e pushtetit në Shqipëri? Cilat janë raportet tuaja me politikanët e Tiranës dhe cila do të ishte këshilla juaj për qeveritarët e rinj?

Kim Mehmeti: Jam larg këshillimit të atyre që drejtojnë shtetin. Por, jam nga ata që besojnë se fati i shqiptarëve jashtë kufijve të Shqipërisë e Kosovës, në masë të madhe varet nga ajo se sa këto dy shtete tona do bëhen ombrellë që do kujdesen edhe për të mirën mbarëkombëtare, ombrellë që neve shqiptarëve të Maqedonisë do na bëjë të ndjehemi si ai vëllai i vogël që ka përkrahë vetes dy vëllezërit e mëdhenj, por që kanë autoritet në mëhallën ku jetojmë dhe nuk njehen inferior nda fqinjëve. Edhe publikisht e kam thënë se kam pasur simpati ndaj Berishës dhe kam pritur krejt diçka tjetër nga qeveria e tij. E kam thënë e do e përsërisë, se vetëm vrulli i tij prej inatçori mund të ndërtonte rrugën e kombit dhe të hapte tunele që

rrezatojnë dritën e ëndrrave tona. Nuk u takojë njerëzve që heqin dorë shpejtë nga «miqësitë», por as atyre që të verbëruar nga miqësia, ecin pas cilitdo që edhe ka gabuar rrugën. Gjithashtu, e kam thënë se vitet e fundit të qeverisjes së Berishës, nuk mund të kishin përkrahjen time dhe se ish-kryeministri shqiptar i ndodhi ajo që është e paevitueshme për pushtetarët që e humbin pushtetin mbi vetvete. Pastaj ndodhi diçka edhe shumë më e keqe se kjo: PD-ja u shndërrua në parti që filloi t'u ngjajë këtyre tonave që i kemi në Maqedoni: të jetë «kompani» private e liderit të saj. Duke u shndërruar në diçka të tillë, PD-ja filloi të ndjehet edhe si pronare e vetme e gjithë Shqipërisë. Kështu që Shqipëria erdhi aty ku ndodhet sot: të mos ketë popull parti që punojnë për interesin e tij dhe të shtetit, por partitë të kenë popullin e vetë që punon vetëm për të mirën e pushtetit dhe të atyre që e drejtojnë atë. Andaj, unë dua një Shqipëri me të cilën do mburremi edhe ne shqiptarët jashtë kufijve të mëmëdheut. Pra, një Shqipëri të cilën do e drejtojnë burrështetasë që do e duan më shumë shtetin e popullin se sa pushtetin, që do punojnë për forcimin e shtetit, e jo të partisë që drejtojnë, që do ndërtojnë institucione shtetërore, që do jenë servisë i qytetarëve, e jo që do mbulojnë destruktivitetin dhe korrupsionin e pushtetarëve.... Nëse qeveria e re e Shqipërisë ia del që ta departizojë vendin, atëherë ajo ka bërë punën më madhështore që duhet bërë. Andaj, nëse edhe kryeministri i porsaemëruar, Edi Rama vazhdon që dështimet e veta t'i mbulojë siç bënte viteve të fundit Sali Berisha, duke nxitur grindje ndërpartiake, atëherë do mund të njollosemi me njollën më të pistë për një popull: ende nuk kemi bosht shtetformues, ende jetojmë në epokën e «bajraktoraokracisë», e cila ka vetëm një qëllim- ta institucionalizojë «hajnokracinë»!

Nga Emirjon Senja



Ligji për nëpunësit civilë, PD-PS “luftë” për militantët

Qeveria shtyu me gjashtë muaj hyrjen në fuqi të ligjit me arsyetimin se ishte i pamundur aplikimi i tij pa aktet nënligjore

Në vigjilje të zgjedhjeve të 23 qershorit, miratimi me votat e maxhorancës dhe opozitës të ligjit të ri për Nëpunësit Civil ishte sinjali i parë për një zbutje të retorikës së ashpër politike. Por përfundimi i zgjedhjeve dhe ardhja në pushtet e një maxhorance tjetër krijoi një situatë të re pikërisht në ditët kur ky ligj ishte parashikuar që të hynte në fuqi, data 1 tetor 2013. Maxhoranca e majtë dërgoi në Kuvend një Akt Normativ me anë të të cilit u siguria shtyrja e hyrjes në fuqi të ligjit deri më datë 1 prill 2014, me arsyetimin se kjo do të jetë koha e mjaftueshme për nxjerrjen e akteve nënligjore të tij, të cilat do të mund ta bëjnë të zbatueshëm.

Por, gjatë “fle lepurit” për demokratët. Sipas tyre, shtyrja e hyrjes në fuqi të ligjit për Nëpunësit Civilë bëhet me qëllimin që maxhoranca e re të ketë dorë të lirë në spastrimin e administratës publike nga punonjësit që kanë shërbyer deri më tani dhe zëvendësimin e tyre me nëpunës të rinj, militantë të majtë sipas saj.

Kjo ndërhyrje e rendësishme në një ligj të miratuar me bekimin e të dyja palëve, është tashmë edhe “casusi” i Partisë Demokratike e cila ka nevojë të mbliidhet rreth një kauze qoftë kjo edhe periferike pas shpartallimit elektoral të 23 qershorit. Që prej fillimit të këtij muaji, opozita ka braktisur të gjithë komisionet



parlamentare duke vendosur si kusht, tërheqjen e Aktit Normativ nga qeveria me qëllim fillimin e zbatimit të ligjit me ndryshimet e miratuara së bashku.

Ndryshimet që opozita dhe maxhoranca miratuan së bashku më 30 maj 2013 parashikonin mbrojtjen e nëpunësve civilë nga shkarkimet arbitrare nga puna. Sipas ligjit të ri, institucionet shtetërore janë të detyruara që t'i gjejnë një

pozicion të ngjashëm pune çdo punonjësi që shkarkohej për shkak të shkrirjes apo ristrukturimit të njësisë ku ai punonte. Por këtë avantazh nuk e siguron ligji ekzistues që do të vijojë të zbatohet deri më 1 prill 2014. Sipas tij, çdo nëpunës, pozicioni i të cilit është suprimuar për shkak të mbylljes së institucionit, largohet nga shërbimi civil. Ndërkohë që për ata nëpunës, vendet e punës së të cilëve suprimohen për shkak

të ristrukturimit në bazë të këtij ligji, shteti ka detyrimin që ata t'i punësojë në një vend pune tjetër të ngjashëm apo më të ulët se ai që ka. Në rast se kjo nuk është e mundur që të realizohet brenda një viti, atëherë ai e humbet të drejtën për të qenë pjesë e administratës. Ky është ndryshimi thelbësor, pasojave të të cilit i trembet opozita e sotme ndërkohë që i japin dorë të lirë maxhorancës së re për të bërë me komoditetin e nevojshëm ndryshimet që shohin të arsyeshme në administratë.

“Me shtyrjen e futjes në fuqi të ligjit, PS do të ketë dorë të lirë për lëvizje në administratë duke mos rënduar edhe arkën e shtetit”

Qeveria, “stop” mbetjeve, ricikluesit kërcënojnë me papunësi

Bizneset e riciklimit punësojnë rreth 1 300 persona, mijëra të tjera sigurojnë të ardhura nga mbledhja e plastikës së kanoçeve.

Qeveria Rama nuk u mendua gjatë për të ndaluar importin e mbetjeve. Në ndër vendimet e para të ekzekutivit të ri ishte ndalimi i çdo lloj importi të mbetjeve me qëllim riciklimin e tyre nga ndërmarrjet vendase. Në këtë mënyrë, kthehet mbrapsht një ndër ligjet më shumë të përfolur të qeverisë Berisha.

Duket sikur ky vendim i qeverisë do t'i jepte fund diskutimeve të gjata në lidhje me këtë çështje, por shmangia e dëmit ekologjik rrezikon të shkaktojë një dëm tjetër, atë ekonomik. Janë dhjetra biznese ricikluese që aktivitetin e tyre e kanë të lidhur me mbetjet, të cilat në pjesën dërrmuese të tyre importohen. Menjëherë pas “stop-it” të qeverisë reagues ricikluesit

duke paralajmëruar falimentimin e tyre si edhe hedhjen në rrugë të më shumë se 1 300 punëtorëve që marrin çdo fund muaji pagën nga ky aktivitet. Sipas tyre, qeveria duhet t'u japë kohë që të rrisin kapacitetet për mbledhjen në vend të lëndës së parë, për mbetjet plastike për shembull. Shqipëria importon çdo vit 600 mijë ton mbetje, kryesisht metale, plastikë por edhe lëndë kimike, mbetje druri etj. Ndërkohë, përllogaritet që vendi ynë prodhon çdo vit të paktën 700 mijë ton mbetje. Në parim, kjo sasi mund të përdoret si lëndë e parë nga bizneset ricikluese, por në Shqipëri mungon ende infrastruktura për ndarjen e mbetjeve sipas përbërjes së tyre duke u hedhur veç plastika, metalet,

qelqi etj. Nisur nga kjo, ricikluesit pretendojnë se nuk mund të përdorin plastikën vendase duke e cilësuar atë të kontaminuar, gjë e cila e bën të domosdoshëm importin.



“Shqipëria importon çdo vit 600 mijë ton mbetje, kryesisht metale, plastikë por edhe lëndë kimike ndërkohë që çdo vit në vend prodhohen të paktën 700 mijë ton mbeturina që mund të përdoren si lëndë e parë nga ricikluesit”



Rama vjen me të "rinjtë",
të papërlyer, por edhe
"kurbane" të lehtë

Emërimi i një shpure të tërë të "rinjsh", jo vetëm në moshë por edhe në aktivitetin politik në zyrat kryesore të shtetit ishte levizja më e përfolur e Ramës në ditët e tij të para në karriken e kreut të ekzekutivit. Tatimet, të cilat derdhin pjesën dërrmuese të të ardhurave në arkën e shtetit do të drejtohen nga Brisida Shehaj. E diplomuar në Fakultetin Ekonomik të Tiranës, ish-drejtoresha e filialit të një banke të nivelit të dytë në Tiranë ka detyrën që t'i sigurojë çdo vit buxhetit të shtetit pjesën kryesore të të ardhurave të çdo viti.

Ndërkohë, në krye të doganave Rama emëroi kryetaren e FRESH-it, Erisa Spiropali. Të dyja "vajzat e Ramës" kanë barrën e sigurimit të rreth 71 për qind të të ardhurave vjetore të Buxhetit të Shtetit. Emrat e tjerë që do të jenë në krye të institucioneve të tjera kryesore të qeverisjes socialiste janë sërish emra

të rinj për skenën politike. Në krye të Albpetrol-it, gjigantit shqiptar të naftës do të jetë Endri Puka, një njohës i mirë i kësaj fushe me bashkëpunime të ndryshme me kompani ndërkombëtare. Arqile Gorea i Postës së Shqipërisë pasohet nga Ardit Çela. 26 vjeçari, i diplomuar për telekomunikacion ka mbajtur postin e Sekretarit për Marrëdhëniet me Publikun në Levizjen Socialiste për Integrim.


Më i thellë ishte operacioni në Policinë e Shtetit. Pas emërimit të Artan Didit në krye të Policisë së Shtetit, me urdhër të ministrit të Rendit Sajmir Tahiri, u ndryshuan edhe drejtorët e policive në të 12 qarqet e vendit si dhe zëvendës drejtorët e përgjithshëm të saj. Ndryshe nga emërimet në dogana, tatime apo në Postën Shqiptare, emrat në Polici kanë një karrierë të gjatë në këtë sektor.

71%

*të të ardhurave
të buxhetit vjetor
të Shqipërisë do
të duhet të fusin
në arkën e shtetit
Brisida Shehaj dhe
Elisa Spiropali*



Nga Ana Uka



Fëmijët dhe teknologjia: Si të rrisim fëmijë të shëndetsëm në një botë digjitale?

Interneti ofron një botë të mrekullueshme argëtimi dhe edukimi për fëmijët dhe të gjithë familjen. Nëpërmjet tij, fëmijët mund të gjejnë informacion pa limit për të realizuar detyrat, mund të komunikojnë me mësuesit dhe bashkëmohatarët e tyre, si edhe të luajnë lojëra interaktive. Në këtë mënyrë, ata gjejnë një mundësi për të zhvilluar jo vetëm aftësitë sociale, por edhe aftësitë

e përdorimit të teknologjisë. Megjithatë përdorimi i tij sjellë me vete një sërë rreziqesh dhe sfidash. Sipas një studimi, për 81% e fëmijëve të moshës 2 vjeç të cilët përdorin internetit. Shumica e prindërve e kanë të vështirë të menaxhojnë marrëdhënien e fëmijëve me teknologjinë. Sot, fëmijët modernë rriten në një epokë ku teknologjia dhe pajisjet digjitale janë në dispozicion të tyre si një alternativë e

dytë. Por, ende normat e standardizuara dhe rregullat e sjelljes që menaxhojnë përdorimin e tyre - si dhe modelet e roleve pozitive dhe me përvojë – nuk janë themeluar. Prandaj lind pyetja: Me të gjitha përfitimet që sjell bota dixhitale, sa e mbrojtur është familja nga përdorimi i këtyre mjeteve? Sa të vetëdijshëm janë prindërit për rreziqet që i kanosen fëmijëve nga përdorimi i tyre?



“Mjetet digjitale ndikojnë në zgjerimin e rrjetit social në botën virtuale të çdo individi dhe pakësojnë komunikimin mes individëve në botën reale. Në këtë mënyrë, ndërveprimi shoqëror mes anëtarëve të familjes pakësohet dhe komunikimi mes tyre bëhet akoma edhe më pasiv”





“Rekomandohet që prindërit të mësojnë përdorimin e mjeteve të ndryshme dixhitale që përdoren nga fëmijët e tyre. Kjo do t’i ndihmojë ata të kuptojnë rreziqet dhe të jenë në gjendje për të biseduar me ta”

Sot, fëmijët, të rinjtë dhe të rriturit janë të ekspozuar ndaj botës digjitale dhe veçanërisht ndaj rrjeteve sociale. Përdorimi i tyre nxitet duke filluar nga autoritetet më të larta të vendit e deri tek bashkëmoshatarët e tyre. Mediat sociale dhe lojërat videogame kanë zëvendësuar si këndet e lojrave për fëmijët, ashtu edhe aktivitetet sociale për të rinjtë dhe të rriturit. Për shumicën e tyre, procesi i njohjes me individë të tjerë dhe shpenzimi i kohës së lirë ndodh shpesh në botën virtuale.

Përdorimi sistematik i mjeteve digjitale dhe rrjeteve sociale konsiderohet si një mënyrë shpëtimi nga përgjegjësitë e fëmijët ndaj mësimeve, si edhe për vetë prindërit ndaj edukimit të fëmijëve apo komunikimit me to. Ato ndikojnë në zgjerimin e rrjetit social në botën virtuale të çdo individ dhe pakësojnë komunikimin mes individëve në botën reale. Në një ambient të përbashkët shpeshherë shohim që çdo pjesëtar i familjes është i angazhuar të paktën me një mjet dixhital

dhe përdorim të rrjeteve sociale. Në këtë mënyrë, ndërveprimi shoqëror mes anëtarëve të familjes pakësohet dhe komunikimi mes tyre bëhet akoma edhe më pasiv.

Një studim i kohëve të fundit nga Nielsen tregon se shtatë nga dymbëdhjetë fëmijë të moshës 2-12 vjeç, të cilët jetojnë në familje që përdorin pajisje dixhitale, prindërit angazhojnë fëmijët e tyre me to, sidomos gjatë udhëtimeve apo gjatë kohës së lirë.

“Si rregull të rëndësishëm duhet të pranojmë se pajisjet e teknologjisë së lartë nuk duhet të përdoren si ‘babysitter’ për fëmijën, por praktikisht, ndonjëherë na nevojitet të përshtatemi me realitetin. Por duke përdorur këto pajisje në vend të vëmendjes që duhet t’i kushtojmë fëmijës ose për t’ua ofruar atyre si një alternativë për të kaluar kohën, është një zakon i keq që aplikohet shumë lehtë por që i kushton shumë fëmijës.”

Prindërit luajnë rolin më të

rëndësishëm në edukimin e fëmijëve. Për t’i mbajtur fëmijët të sigurtë nga përdorimi i internetit, prindërve u nevojiten një sërë aftësish për të përballuar sfidat e shekullit të 21-të, të cilat ndryshojnë strukturën e kulturës familjare. Gjithashtu, rekomandohet që të gjithë prindërit, fëmijët, mësuesit, instancat qeveritare, ligjvënësit etj. të bëjnë pjesën e tyre në peshën e kësaj përgjegjësie, e cila kërkon angazhim nga të gjitha palët.

Prindërit duhet të jenë shumë të vetëdijshëm për atë që fëmijët shohin, dëgjojnë në internet, apo për ata me të cilët mund të takohen, dhe çfarë ndajnë me ta online. Ata duhet të marrin parasysh se fëmijët gjatë përdorimit të internetit mund të ekspozohen ndaj përmbajtjeve që janë seksualisht eksplicite, të dhunshme, të ndaluara apo edhe të paligjshme. Gjithashtu, ata mund të përjetojnë ‘cyber bullying’ (ngacim kibernetik) ose mund të jenë në rrezik nga kontakti me të huajt. Duke marrë një rol aktiv në edukimin

e fëmijëve në lidhje me rreziqet që u kanosen dhe duke iu përgjigjur pyetjeve të tyre apo shqetësimeve në lidhje me përdorimin e internetit, prindërit mund t'i ndihmojnë ata të jenë më të sigurt gjatë përdorimit të tij.

Rekomandohet që prindërit të mësojnë përdorimin e mjeteve të ndryshme dixhitale që përdoren nga fëmijët e tyre. Kjo do t'i ndihmojë ata të kuptojnë rreziqet dhe të jenë në gjendje për të biseduar me ta. Gjithashtu, prindërit mund të bien dakord me fëmijën për vendosjen e disa rregullave për përdorimin e internetit duke i postuar ato në mënyrë të qartë në afërsi të kompjuterit, i cili është i vendosur në një zonë të përbashkët të familjes dhe jo në dhomën e gjumit të fëmijës. Për t'u siguruar se çfarë përmbajtje shihet dhe shkarkohet nga interneti dhe për të kufizuar përdorimin e tij, mund të instalohet një filtër përmbajtje interneti.

Fëmijët duhet të edukohen dhe të paralajmërohen që të mos ndajnë asnjë informacion personal apo foto në internet duke përfshirë këtu: adresën postare, numrin e telefonit, emrin e shkollës së tyre, apo çdo informacion që mund të lejojë që dikush të mësojë më shumë rreth tyre. Prandaj, koha që fëmijët kalojnë përpara ekranit duhet të jetë gjithmonë e kufizuar dhe ekspertët rekomandojnë jo më shumë se një apo dy orë të kohës në ekran në ditë. Dita mund të mbushet me aktivitete të tjera të shëndetshme në botën reale. Prindërit duhet gjithmonë të bëjnë kujdes për shpenzimin e kohës së lirë të fëmijëve, e cila ka vlera të dobishme dhe të shëndetshme për të gjithë.

Ashtu si çdo çështje sigurie, është shumë e rëndësishme që prindërit të flasin rreth shqetësimeve të tyre me fëmijët, të përfitojnë nga mënyrat e ndryshme për t'i mbrojtur ata, dhe të jenë në dijeni të aktiviteteve të tyre nëpërmjet një komunikimi sa më aktiv.



**“Fëmijët
duhet të edukohen dhe të
paralajmërohen që të mos
ndajnë asnjë informacion
personal apo foto në internet
duke përfshirë këtu: adresën
postare, numrin e telefonit,
emrin e shkollës së tyre, apo
çdo informacion që mund të
lejojë që dikush të mësojë më
shumë rreth tyre”**



Nga Alban Tartari



Kur demokracia
bëhet sheqer...



Një ditë më parë nuk kam dal nga automjeti im, ndonëse kisha mbërritur në destinacion. Radio BBC po shpjegonte termin e çuditshëm “government shut down”... Bëhej fjalë për mbylljen e qeverisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës! Ajo që unë nuk kuptoja është se si mund të mbyllet qeveria! Dhe ku? Në SHBA! Me gazetarinë dhe elokuencën e tyre, dy moderatorët përmes 3 të ftuarve e shpjeguan ngjarjen në ato 5 minuta.

Qeveria s'kishte para për të paguar administratën, sepse Kongresi nuk e kishte çelur “rubinetin” e parave! Çfarë po ndodhte? Ose më mirë, si mund të ndodhte diçka e tillë në vendin më demokratik, më të zhvilluar dhe më të kujdesshëm ndaj të drejtave të njeriut?

Si mund të mbyllet shteti? Mbjaj mend që shteti i rrënuar shqiptar mundahej të mbahej edhe në vitin 1997, ndoshta koha më e keqe e historisë moderne në vendit tonë... Mbjaj mend, edhe pse shteti heshti në Vlorë për një 6 ose 7 muaj, pas kësaj periudhe, tre makina hynë në qytet: makina e forcave ushtarake të misionit ndërkombëtar të paqes (trupat italiane), makina e policisë që erdhi nga Fieri (se të Vlorës u dogjën!) dhe makina e bankës që solli rrogat për të 7 muajt! Vini re! Askush nuk punoi gjatë kësaj kohe! Përveç zyrtarëve të ndershëm shtetërorë që i ruajtën dokumentat (shpesh në shtëpitë e tyre) dhe zyrat si të ishin shtëpitë e tyre, që të mos dëmtoheshin nga vandalët!

Pra, kishte edhe nga ata që profesor Artan Fuga i trajton me klas në librin e tij “Rrota e Mundimit” (“Bisedë telefonike natën me një polic”, faqe 351). Dhe këta e meritonin rrogën. Por ishin shumë pak. Pra, shkurt e shkoqur, shteti nuk mund të mbyllet. Ai ka një kontratë me qytetarin/punonjës i administratës. Dhe në Shqipëri ishte faji i shtetit që mori fund shteti. Kështu që qytetarët i morën rrogat e tyre.

Në SHBA nuk ka luftë, as ndonjë zallamahi tjetër. Çudia e madhe është se lufta dhe zallamahia janë politike. Republikanët u përpoqën të bllokoni programin e Presidentit Obama për shëndetësinë (ObamaCare). Me këmbënguljen e tyre dhe me

këmbënguljen si përgjigje të demokratëve, republikanët mbyllën shtetin. Bota po sheh e çuditur. Tetëqind mijë punonjës, përveç ushtarakëve që s'mund të dezertojnë, aktualisht janë pa punë. Ose edhe nëse janë në punë, janë pa pagesë.

Nga ky kënd i largët i botës, që është edhe shumë larg demokracisë amerikane, lind pyetja: si mund të bllokosh shtetin për kapriço politike? Si mund të pretendosh që e bën për qytetarin e për shtetin, kur ke bllokuar e penalizuar shtetin e qytetarin në mënyrë direkte? A është kjo demokraci?

Duhet të jenë të shumtë ata që do nxjerrin përkufizimet/definicionet e demokracisë. Si është, si duhet të jetë... Dhe në fund të këtij mendimi, do preferoja ta krahasoja demokracinë me sheqerin. Demokracia është e ëmbël si sheqer. Të paktën ashtu na duket. Të paktën mendojmë që është sistemi më i ëmbël “hë për hë” në faqe të dheut, më miqësori ndaj të drejtave të njeriut, më gjithëpërfshirësi, por kurrësesi më perfekt. Rrugës dalin edhe gropa, ku sistemi ngec.

Por, aq sa është i mirë sheqeri, aq edhe i keq bëhet kur shkakton sëmundjen më të rrezikshme për njeriun, diabetin! “Dhe ky diabet hëngri burra si Enveri” thuhej dikur me një seriozitet solemn (e qesharak në të njëjtën kohë), duke mbivlerësuar edhe sëmundjen edhe Enver Hoxhën.

Në rastin konkret, demokracia sheqer solli edhe “sëmundjen”, e cila mbylli një shtet të tërë. Ndaj edhe revista prestigjioze amerikane “TIME” do t'i hiqte një vizë “rregullit të shumicës” në demokraci, në kopertinën më të fundit, ku Capitol Hill - Kongresi shfaqen nën një qiell të vrarë.

S'ka asnjë dyshim, ndoshta derisa këta rreshta të faqosen nga kolegët e revistës “Objektiv” e të printohen e të vijnë në duart e tua i nderuar lexues, kriza në SHBA do ketë marrë fund. Dikush do të tërhiqet. Dikush do të bëjë pas. Ndoshta edhe të dy palët. Pasi demokracia bëhet e frikshme “elektoralisht” për të dy palët. Pikërisht ata që u penalizuan, të penalizojnë në rutinë e parë të votimit që do t'u dalë përpara.

“Por, ia vlen që edhe ne, të largët e demokracisë, të hedhim një sy kritik mbi demokracinë amerikane, duke mësuar për të mos bërë marrëzi në Tiranë”



Ekonomia, probleme të vjetra për qeverinë e re

Qeveria e re ngjan me një amvisë, e cila sapo ka hyrë në kuzhinë, ndërkohë që tavolinën e ka plot me të ftuar dhe duhet të fillojë të gatujë për të gjithë, pa ditur sasinë e ushqimeve që ka në dispozicion. Përpos rivendosjes së rendit publik, dhembja e parë e kokës për kreun e ri të qeverisë është situata në të cilën gjenden financat e vendit, ekonomia si edhe detyrimet e prapambetura që shteti shqiptar ka ndaj privatëve.

Me të ardhurat tatimore dhe doganore në rënie, ulje të aktivitetit ekonomik, (më pak taksa në buxhet), si edhe nevojën emergjente të kompanive private për t'u paguar për punët e kryera në emër të qeverisë, duket se dimri që kemi në prag do të jetë një ndër më të "ftohtët" për kabinetin Rama.

Qeveria u detyrua të ndalonte të gjithë shpenzimet operative: rregullimin e zyrave, blerjen e orendive apo edhe blerjen e letrës dhe bojës së printerave, për shkak mungese buxheti prej 17 miliardë lekë.

Tatimet dhe doganat

Me t'u ulur në kolltukun e paraardhësit të tij si ministër i financave, ish-gubernatorit të Bankës së Shqipërisë, Shkëlqim Canit iu desh të bënte llogaritë për përmbylljen e vitit buxhetor me të paktën 167 milionë dollarë më pak të ardhura në arkë, nga sa ishte parashikuar nga qeveria. Sipas të dhënave zyrtare të publikuara nga Ministria e Financave, buxhetit të shtetit i munguan të paktën 17 miliardë lekë, të cilat nuk u mbledhën nga organet tatimore dhe doganore ashtu siç ishte parashikuar.

Por më shumë shqetësues se mosmbledhja e të ardhurave në buxhet janë zërat, në të cilat vërehet pjesa më e madhe e mosrealizimit. Kështu për shembull, përveç efektit negativ në arkën e shtetit, gropa prej 9 miliardë lekësh e krijuar nga të ardhurat nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) është një

tregues tepër problematik. Ajo pasqyron drejtpërdrejtë edhe rënien e konsumit në vend. TVSH është një tatim që paguhet nga konsumatori fundor dhe si i tillë pasqyron direkt ecurinë e blerjeve që bëhen në vend.

Por çfarë ndodh me të ardhurat nga doganat, të cilat japin kontributin e dytë kryesor në të hyrat e buxhetit të shtetit ? Rënia e aktivitetit ekonomike në vend nuk kishte se si të mos ndikonte edhe në hyrjen e mallrave në dogana, duke marrë parasysh edhe faktin se tregu vendas i përmbush nevojat kryesisht nga importi. Referuar të dhënave zyrtare, buxhetit të shtetit i mungojnë rreth 8 miliardë lekë nga mosrealizimi i të ardhurave nga doganat deri në fund të muajit korrik. Më shumë se nga paaftësia e administratës doganore për të mbledhur detyrimet, mosrealizimi duket se ka ardhur më shumë nga rënia

e sasisë së mallrave që janë futur në Shqipëri gjatë kësaj periudhe. Madje, Shqipëria importon sot më pak mallra krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2011.

“Shqipëria importon sot më pak mallra krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2012”

Biznesi

Edhe pse qytetarët kanë prirjen të jenë optimistë për të ardhmen e tyre financiare, biznesi nga ana tjetër parashikon ditë jo të mira për pjesën e mbetur të këtij viti. Të dhënat nga vrojtimet e Bankës së Shqipërisë

tregojnë se sektorë, si: industria, ndërtimi si edhe shërbimet janë skeptikë për ecurinë e aktivitetit të tyre në muajt e ardhshëm.

Borxhi i privatëve

Por pasi të ketë marrë masat me qëllim stabilizimin e treguesve makroekonomike, qeveria do të duhet të gjejë një zgjidhje për punët e papaguara që kompanitë private kanë kryer në emër të shtetit shqiptar gjatë viteve të fundit. Zyrtarisht, bëhet fjalë për një borxh rreth 70 milionë dollarë që shteti shqiptar i ka kompanive, të cilat

kanë realizuar deri më tani punët publike kryesisht në infrastrukturë. Kjo është shifra që deklarohet nga Thesari i Shtetit, ndërsa pas një kontrolli të ushtruar në Ministrinë e Financave, Kontrolli i Lartë i Shtetit arriti në përfundimin se ky borxh është të paktën 6 herë më të madh, plot 400 milionë dollarë.

Borxhi publik

Të gjithë këto operacione, Cani dhe Rama duhet t'i bëjnë në një kohë kur Borxhi Publik i ka kaluar tashmë kufijtë ligjorë të parashikuar dhe parashikohet të shkojë të paktën në 64 % të Prodhimit të Brendshëm Bruto. Kjo është shifra e pranuar zyrtarisht në një kohë që qeveria i ka të paktën

400 milionë dollarë para të papaguara kompanive private, të cilave gjithashtu ia ka premtuar. Bashkë me këtë shifër, niveli i borxhit pritet të rritet edhe më tej. Në këto kushte, e vetmja zgjidhje e pritshme është ajo e shkurtimeve të dhimbshme, të cilat na prekin direkt apo indirekt të gjithëve.

“Zyrtarisht, bëhet fjalë për një borxh rreth 70 milionë dollarë që shteti shqiptar i ka kompanive që kanë realizuar deri më tani punët publike kryesisht në infrastrukturë”

167
milionë dollarë
i mungonin arkës
së shtetit deri
para ndryshimit
të buxhetit.
diferencën në
fjalë qeveria
e mbylli duke
shkurtuar
shpenzimet



Nga Gentiana Skura



Marrëdhëniet me publikun – domosdoshmëri për trashëgiminë kulturore shqiptare

Trashëgimia kulturore shqiptare është një nga vlerat dhe gurët e çmuar të së shkuarës, të së tashmes dhe dëshirojmë, edhe e së ardhmes sonë, pasi tek ajo projektohet identiteti ynë kombëtar dhe po ashtu edhe krenaria jonë kombëtare. Flitet kaq shumë në ditët tona për trashëgiminë kulturore, por sa e njohim dhe sa të prekshme e kemi atë ne shqiptarët e sa interesante mund të jetë ajo edhe për të huajt. Natyrisht, që në këtë pikë përpos të tjerave, roli i PR dhe marketimit kulturor është tejte domethënës, sidomos në institucionet që veprojnë në lëminë e trashëgimisë kulturore në veçanti dhe artit në përgjithësi, e që ndërvaren nga Ministria e Kulturës.

Viti 2005 mund të cilësohet si një kufi

kohor, kur roli i zëdhënësit nisi të jetë i pranishëm në institucionet kulturore, vetëm se nën emrin e zyrave të marrëdhënieve me publikun, ai identifikohet si person që merret me njoftimin e takimeve, konferencave të shtypit dhe aktiviteteve. Ndërkohë që aktiviteti i marrëdhënieve me publikun është tejte i gjerë dhe kompleks e zyra e shtypit është vetëm një nga mjetet e strategjitë e përdorura për komunikimin me publikun.

Disa nga institucionet qendrore të kultures, si: Teatri Kombëtar i Operas dhe i Baletit, Teatri Kombëtar, Teatri Kombëtar i Komedisë apo Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit mund të konsiderohen si institucionet që kanë PR funksional, por ama nuk kanë institucion të specialistit

të marrëdhënieve me publikun. Këtë rol e kanë marrë asistentët e drejtuesve të institucioneve. Megjithatë, fakt është se prej tyre vijnë njoftime permanente, ka përcjellje informacionesh për aktivitete dhe çka është me shumë rëndësi, edhe marrja e informacionit për çështje të ndryshme në përditshmërinë e punës së reporterit. Në institucione të tilla, si: Biblioteka Kombëtare, Galeria Kombëtare e Arteve, Muzeu Historik Kombëtar, rolin e PR e bëjnë punonjës të panjohur me fushën e PR, madje në shumë raste këtë rol e kanë luajtur drejtuesit e



institucioneve. Detaj ky që flet jo pak se ç'mendohet për komunikimin në këto institucione. Akoma më keq është situata e Institutit të Monumenteve të Kulturës (IMK), një ndër institucionet më të rëndësishme të kulturës në vend, i trashëgimisë së kulturës materiale, që jo vetëm nuk ka sektor të marrëdhënieve me publikun, por as edhe punonjës përgjegjës për komunikimin me mediat.

Pakkush prej nesh mund të dijë se prej pak vitesh ekziston edhe Agjencia e Shërbimit Arkeologjik (ASHA)/ Ajo është agjenci tepër e rëndësishme sa i takon aseteve arkeologjike të vendit tonë, e cila sërish nuk e njeh institucionin e specialistit të PR. Nëpërmjet kësaj agjencie kalojnë vendimet më të rëndësishme në lëminë e arkeologjisë në vend, prej nisjes së ekspeditave deri te rezultatet e këtyre ekspeditave, dëshmi të trashëgimisë arkeologjike në vend. Mirëpo mungesa e profesionistit të PR sjell mospraninë e plotë të veprimtarisë së ASHR-së dhe rezultati është që në media nuk flitet aspak për të, ashtu sikundër edhe publiku mëson vetëm kur ndodh diçka e jashtëzakonshme në lëminë e arkeologjisë, zbulime apo dëmtime të objekteve apo zonave arkeologjike, siç kohët e fundit jemi informuar me shkatërrime të një pjese të ikonografisë aq të çmuar shqiptare. E njëjta situatë është edhe me Qendrën

Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore (QKIPK). Pakkush e di që ky institucion kryen pajisjen e objekteve të trashëgimisë kulturore me pasaportë. Është institucioni ku monumentet e kulturës, pikturat murale (afresket), ikonat, pikturat që mbajnë firmën e piktorëve të zëshëm dhe çdo objekt me vlerë apo me më pak vlerë, janë të skeduar. Kjo nënkupton që nëse një objekt çfarëdo qoftë ky mund të bjerë pre e trafikimit, mundet të identifikohet lehtësisht nga Interpoli, pasi pasaporta e objektit gjendet në skedarët elektronikë tanimë të këtij institucioni, i themeluar në vitin 1990.

Sa i takon trashëgimisë shpirtërore, një ndër institucionet qendrore është Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike (QKVF). Edhe kjo është një ndër ato qendra që mbart vlera, që organizon jo pak aktivitete megjithatë, për shkak të marketimit mediatic gati inekzistent, mungon kontakti me publikun. Natyrisht që në këtë shkrim nuk mund të përmenden një rrjet i gjerë qendrash e institucioneve kulturore në qytete të ndryshme të Shqipërisë, për të cilat PR është i panjohur si sektor apo edhe në rol



zëdhënësi. Megjithëse për nga rëndësia janë mbarëkombëtare, pasi janë qendrat më të vizitueshme të trashëgimisë kulturore, në një vështrim, humbasin shumë nga mungesa e PR. Duke qenë se shumica e tyre kanë punë direkte me vizitorët, ata nuk provojnë sa duhet resurset e tyre, për të mos folur për strategji të mirëstrukturuara promovuese. Prezenca e pakët në media do të thotë pak apo aspak informacion për ç'ka këto institucione ofrojnë për publikun (vizitorët potencialë të tyre). Dhe një pjesë e madhe e trashëgimisë kulturore mbetet vetëm në shijen e dikujt që është tejet i interesuar, e jo për vizitorë të interesuar për Shqipërinë.

S'mund të mos ritheksohet fakti që PR duhet të marrë rolin që i takon, atë të një institucioni brenda institucionit, sepse është shumë i domosdoshëm për institucionet kulturore, për trashëgiminë kulturore që ajo të mund të jetë e prekshme nga publiku. Megjithëse vijojmë të kemi një pasuri të madhe kulturore, pa ndihmën e PR specialistëve do ta kemi ende të panjohur, ose në raste të ndryshme edhe të cunuar. Kuptohet, me ndihmën e PR kjo trashëgimi do jetë shumë atraktive edhe për të huajt, të cilët do shfaqin edhe më shumë interes për të vizituar Shqipërinë. Kësisoj e gjithë kjo përkthehet në resurse të mira kontaktesh kulturore, burime ekonomike më të shumta nga turizmi kulturor shqiptar si dhe një imazh dhe reputacion në rritje i Shqipërisë.



Nga Erlis Çela



Revanshi i antivlerave dhe kultura e mosreagimit

Në dy dekadat e fundit, një nga temat e debatueshme në opinionin publik është indiferentizmi i shoqërisë shqiptare ndaj ngjarjeve, fenomeneve dhe dukurive që shqetësojnë qytetarin shqiptar në ditët e sotme.

Çdo ditë e jonë, që nga momenti që dalim nga shtëpia dhe deri sa kthehemi sërish në mbrëmje është e mbushur me ngjarje të hidhura dhe dukuri negative. Ne shpesh jemi dëshmitarë të sjelljeve të pahijshme të bashkëqytetarëve dhe të nëpunësve të shtetit.

Pa dashur të portretizoj një panoramë tërësisht të errët, ajo që dua të vë në dukje është fakti se gjatë ditës sonë të zakonshme ndodhin aq shumë gjëra (të cilat kërkojnë reagimin tonë si individ, si qytetar, si intelektual, si opinionbërës, si politikan, si drejtues etj.), sa të qëndrosh pa folur duket thujtë një mision i pamundur. E megjithatë, reagimi ynë është thujtë inekzistent. Në rastin më të mirë reagojmë, por zëri ynë është i vetmuar dhe i dobët, duke moskumbuar sa duhet për veshët e shurdhët të atyre që kanë në dorë të ndryshojnë diçka, në rastin më të keq mjaftohemi me rregullin e vendosur brenda pragut të shtëpisë sonë, duke mos na bërë përshtypje as edhe shkalla e pallatit që gëlon nga pislëku dhe

plehrat.

Në të dyja rastet, ne nuk arrijmë të vëmë në lëvizje mekanizimin e përmirësimit të gjërave. Atëherë, kur reagojmë qoftë edhe të vetëm, kemi dështuar në aspektin social, komunitar dhe shoqëror, pasi nuk kemi arritur të bindim asnjë tjetër veç vetes për kauzën që duam të ngrejmë. Megjithëse, në shumicën e rasteve, fajin e kërkojmë te të tjerët. Kjo tregon mungesën e kulturës bashkëvepruese për një interes të përbashkët, tregon mungesën e kulturës së konsensusit. Ndërkohë që në rastin e dytë, kemi të bëjmë me një gjendje akoma më të rëndë. Është faza kur njeriut i është krijuar ajo perdja e syrit që nuk e lejon të shquajë “të pazakontën”, i është ndryshkur aq shumë ndërgjegjja, sa që nuk arrin të bëjë diferencën mes të mirës dhe të keqes. Kjo fazë i ngjan shumë zemrës së një besimtari që errësohet ngadalë pas çdo mëkati të kryer deri sa merr e gjitha ngjyrën e errët dhe mëkatet, nuk janë më mëkate për individin. Unë mendoj se, për fat të keq, ka shumë në këtë vend që janë pikërisht në këtë fazë.

Por, gjithësesi, duke mos dashur të ngec në batakun e pesimizmit, do t'i rikthehem përpjekjes së njeriut, i cili mbarë dëshirën për t'i ndryshuar gjërat në drejtim pozitiv. Kjo kategori përbën shumicën

dërrmuese të një shoqërie dhe, si e tillë, duhet që t'i gjejë rrugët për ta bërë publike dhe për ta mbrojtur kauzën e drejtë. Duke u ndalur pikërisht në këtë pikë, do të thoj se media është një platformë që do t'i vinte në ndihmë kësaj pjese të shoqërisë.

Në librin e tij “ Deontologjia e mediave”, Claude- Jean Bertrand ndalet edhe në funksionet e mediave, ku ndër të tjera nënvizon funksionin e “sigurimit të komunikimit social”. “Në një botë demokratike është e domosdoshme që nëpërmjet diskutimeve të shkohet drejt kompromiseve, drejt një konsensusi minimal, pa të cilin nuk mund të ketë bashkekzistencë paqësore.

Në shoqërinë aktuale të urbanizuar në mënyrë masive, forumi ku zhvillohet debati shoqëror ofrohet nga mediat”- shprehet autori.

Por, ky funksion vlen për një media të përgjegjshme që, ndonëse funksionon mbi bazën e ligjeve ekonomike të tregut, e ka të qartë se produkti që ajo ofron është ndryshe nga të tjerët. Media sot, në shumicën e rasteve, nuk arrin të bëhet zëdhënëse e zërit të atyre njerëzve që folën më lart, të cilët janë të shqetësuar për një fenomen, për diçka që nuk shkon si duhet dhe mundohet të reagojë. Media jonë është larg dhe e shkëputur nga



axhenda reale e njerëzve. Ajo merret më së shumti me axhenda të diktuar nga grupe të ndryshme interesi ose me axhenda të importuara që nuk kanë kurrëfarë lidhje me realitetin shqiptar.

Sot është shumë e vështirë që të gjesh në mediat shqiptare programacion që flasin për vlerat, për vlerat tona si shoqëri, për traditat, për vlerat e familjes etj. Më tepër jemi të prirur të flasim për antivlerat, sesa për vlerat dhe, në këtë pikë, nuk mund të fajësohen vetëm mediat. Kjo është një dukuri më e gjerë se kaq. Për ta kuptuar më mirë këtë, po u kushtohet më shumë vëmendje martesave brenda të së njëjtës gjini, sesa problematikës së divorcive dhe krizës së familjes. Ndonëse çështja e martesave mes të së njëjtës gjini

është një axhendë tërësisht e importuar dhe pa asnjë lidhje me aktualitetin vendas. Kjo temë serviret me ngulm dhe në mënyrë të vazhdueshme në hapësirën mediatike shqiptare. Madje, në shumicën e rasteve, kjo temë shfaqet me një mënyrë tinzare, duke e kamufluar dhe duke e trajtuar atë si një çështje që ka të bëjë me emancipimin shoqëror, nivelin e demokracisë dhe integritimin e vendit në Bashkimin Europian. E keqja e kësaj qëndron më shumë në faktin se kjo çështje po shtrohet me ngulm nga institucione që funksionojnë me taksat e gjithë shqiptarëve. Ndonëse dihet shumë qartë se s'ka asnjë lidhje me çështjen e integritimit. Edhe pse një nga themeluesit e Bashkimit Europian, siç është Italia nuk e ka miratuar një ligj të tillë, përsëri

vazhdohet të këmbëngulet në këtë drejtim.

Përballë kësaj situatë, ku antivlerat ka marrë revanshin dhe po mbytet vlerat, shumica e shoqërisë që është për të mbrojtur vlerat, nuk arrin të bashkojë zërin dhe ta përcjellë atë për gjithë opinionin. Shoqëria civile, e cila mund ta luante shumë mirë këtë rol, është pothuajse inekzistente dhe e korruptuar, siç janë dhe një pjesë e mirë e institucioneve publike në këtë vend.

Tashmë ka ardhur koha që aktorët e kësaj shoqërie të reagojnë ndaj këtij revanshi, pasi kemi të bëjmë me një dukuri më të rrezikshme se prerja e pemëve, ndotja e mjedisit apo importi i plehrave. Kemi të bëjmë me "helmimin" e gjithë shoqërisë.



Nga Rovena Xhili



10 mënyra të thjeshta se si mund të rrisni fuqinë e mendjes suaj

Sa shpesh keni menduar për trurin tuaj? A keni ndaluar ndonjëherë për të parë pushtetin e mrekullueshëm të këtij organi suprem? Keni menduar se si mund të rrisni fuqinë e mendjes suaj?

Nëse jeni si pjesa më e madhe e popullsisë atëherë përgjigjja juaj është “ jo”

Në mënyrë të habitshme, ne përdorim vetëm 10% të mendjes sonë, madje njerëzit e zakonshëm nuk mendojnë as për një trajnim të kësaj mendje që zotërojnë. Për një kohë të gjatë, ndër shkencëtarë qarkullonte mendimi se ne jemi të burgosur në trurin me të cilin kemi lindur! Fatmirësisht për ne, kjo hipotezë nuk është më e pranueshme. Tani neuroplastika ka zbuluar një fakt të ri tronditës: “truri mund të ndryshojë”. Ç’do të thotë kjo? Pra, nëse ti nuk je inteligjent mjaftueshëm në një zonë të caktuar, ky nuk është fundi, ju mund të përmirësoni këtë zonë delikate. Mjafton pak trajnim.

Një mënyrë e thjeshtë për ta parë këtë: Truri është një si muskul dhe si çdo muskul ka nevojë të stërvitet rregullisht. Dhe e dini ku është pjesa interesante e gjithë kësaj?! Nuk keni përse të shpenzoni milionat për të stërvitur muskujt tuaj, por me shpenzimin e pak kohe në mënyrë të rregullt ju mund të arrini sukses.

Nëse po mendoni nga mund t’ia nisni, më poshtë do të gjeni 10 mënyra të lehta për të përmirësuar intelegjencën tuaj.



1. Bëj diçka të re.

Nëse mendoni se ç’lidhje kanë gjërat e reja me intelegjencën, atëherë e keni kuptuar gabim se edhe këtu ekziston një korelacion. Sa herë ju bëni diçka të “re” ju aktualisht po “stimuloni” trurin tuaj. Mos ju bëhet zakon të bëni gjithmonë të njëjtat gjëra të vjetra. E vetmja zgjidhje për të ndryshuar strukturën e trurit tuaj është të provoni diçka të re. Në këtë mënyrë do të krijoni rrugë të reja nervore duke rritur intelegjencën tuaj. Ju mund të merrni një rrugë të re për në punë, mund të provoni një recetë të re për darkë ose mund të ndryshoni metodikën me të cilën keni studiuar më parë etj.

2. Ushtrohu rregullisht.

Është provuar se ushtrimi i rregullt i trupit rrit funksionimin e rregullt të trupit si dhe neurogjenezën. Kjo do të thotë se çdo herë që ju ushtroheni krijoni qeliza të reja nervore. Pra, çohuni dhe lëvizni, truri juaj do t’ju falenderojë për këtë.

3. Trajtoni kujtesën tuaj.

Sa herë dëgjojmë njerëz që thonë “Do doja të kisha një kujtesë më të mirë”, por ndërkohë askush nuk bën gjë në lidhje me këtë problem. Nëse nis ta disiplinosh veten për të mësuar numra telefoni përmendësh, por dhe numra të tjerë të

rëndësishëm, si: pasaportë, kartë krediti, patentë, ju do të vëreni një përmirësim të dukshëm të kujtesës tuaj.

4. Jini kurioz.

Në vend që t’i merrni gjërat e mirëqena në formën që kanë dhe në formën që janë, rrisni zakonin e ngritjes së pyetjeve qoftë për gjëra të thjeshta, për produkte apo shërbime me të cilat viheni në kontakt. Duke qenë kureshtar nga çdo pyetje që bëni ju përfitoni pjesë të reja të informacionit. Kurioziteti mund të ketë vrarë mace, por ai krijoi gjëra super të rëndësishme si elektriciteti dhe kompjuterat.



5. Mendoni pozitivisht.

Stresi dhe ankthi vrasin neuronet ekzistuese të trurit dhe gjithashtu ndalojnë krijimin e neuroneve të reja. Kërkimet kanë treguar se të menduarit pozitiv sidomos për të ardhmen përshpejtojnë krijimin e qelizave në mënyrë dramatike dhe në të njëjtën kohë zvogëlon stresin dhe ankthin. Provo të trajtosh mendimet negative dhe t'i zëvendësosh ato me mendime pozitive.

6. Hani shëndetshëm.

Dietat tona kanë një ndikim të madh

në funksionin e trurit. Truri ynë konsumon mbi 20% të të gjithë lëndëve ushqyese dhe oksigjenit që ne konsumojmë. Kështu nuk duhet të lëmë pas të ushqyerit shëndetshëm (fruta të freskëta, perime, vaj ulliri, mishra të peshkut (i cili është shumë i pasur me Omega 3)).

7. Lexoni një libër.

Leximi heq tensionin dhe stresin, sepse kjo është një formë ikje nga realiteti. Siç dihet, ai është një ndër format më të suksesshme për të nxitur imagjinatën.

Studimet kanë treguar se imagjinata është një formë trajnimi për mendjen, pasi kur imagjinon e detyron mendjen të fotografojë atë që ka lexuar.

8. Bëni gjumë të mjaftueshëm.

Gjumi është si një minidetoksifikim i trurit. Kjo është periudha kur trupi rigjeneron qelizat dhe heq të gjitha toksinat që ka ndërtuar gjatë ditës nga organizmi. Për një të rritur, 7.5 deri në 9 orë gjumë janë më se të mjaftueshme.

9. Rikthe metodat e vjetra.

Në ditët e sotme askush nuk e ka idenë e një orientimi konkret në hapësirë, duke qenë se të gjithë përdorin mjet personal transporti të shoqëruar mundësisht me GPS, ose në rastin më të thjesht duke përdorur transportin publik. Por ndonjëherë është mirë rikthimi në kohët e vjetra. Bëjeni trurin tuaj si një hartë dhe përdoreni që ai t'ju orientojë kudo që ju të keni nevojë. Besomëni nuk do të zhgënjeheni.

10. Braktis kalkulatorin.

A i mbani mend kohët e vjetra, kur nuk përdornim laptopë, ose telefonë për të llogaritur veprime, madje dhe ekuacione? Kurse sot teknologjia dhe zhvillimet e saj sikur na kanë dembelosur në një farë mënyre dhe ne kemi lënë pas çdo lloj veprimi me mendje. Ndoshta është koha të braktisim këto mjete të jashtme dhe të rikthehemi te diçka e jona, të rikthehemi dhe njëherë tek e brendshmjia, te e fuqishmjia, që është truri ynë ...



Nga Rudi Dunga




“Njohjet e Kosovës në prag të 6-vjetorit të Pavarësisë”

Tajlanda ishte vendi i 104-t që njohu Pavarësinë e Republikës së Kosovës. Konfirmimi i njohjes më të fundit erdhi gjatë qëndrimit të kryeministrit Hashim Thaçi në fund të shtatorit në Nju Jork, ku zhvilloi një takim edhe me kryediplomatin tajlandez, Surapong Tovichakchaikul. Kosova po mbush gjashtë vjet që nga Shpallja e Pavarësisë më 17 shkurt 2008. Nënshkrimi dhe miratimi solemnisht i Deklaratës së Pavarësisë në Kuvendin e Kosovës ishte një nga ngjarjet më të shënuara në historinë e kombit shqiptar, që pas aktit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntor 1912.

Një nga detyrat më emergjente që u shfaqen para shtetit të Kosovës dhe vendeve mbështetëse të pavarësisë së saj ishte angazhimi për njohjen në arenën ndërkombëtare. Për t’u fokusuar pak në statistika, kur Kosova mbushi një vit si shtet, atë e njihnin plot 54 vende, duke nisur nga Afganistani që e bëri i pari e deri te Panamaja që e njohu zyrtarisht më 16 janar 2009. Në vitin e dytë, Kosova u njoh nga 11 vende

të tjera, për t’iu shtuar 10 në vitin e tretë, 13 vende në të katërtin dhe sërish 10 shtete të tjera e njohën Kosovën, duke e çuar në 98 numrin e njohjeve të saj kur kishte mbushur 5 vjet nga shpallja e Pavarësisë.



Suksesi i diplomacisë kosovare

Pikëpyetja më e rëndësishme që ngrihet në fund të vitit 2013 lidhet me suksesin e diplomacisë kosovare. A ndodhet ajo në rrugë të mbarë për të rritur numrin e njohjeve? Për të arritur rezultate më të mira? Më 8 prill 2011, z. Behgjet Pacolli u zgjodh zëvendëskryeministër i parë i qeverisë së Kosovës, nga gjashtë sa ka gjithsej. Ai është i angazhuar për marrëdhëniet ndërkombëtare, për të siguruar njohje të reja për shtetin e Kosovës, krahas punës së Ministrisë Punëve të Jashtme. Që prej marrjes së asaj detyre nga z. Pacolli, Kosovën e kanë njohur 28 vende. Duke u bazuar në statistika, emërimi i tij nuk është se solli ndonjë rritje të ndjeshme, për më tepër, në momente të caktuara janë shënuar edhe përplasje me ministrin e Punëve të Jashtme, z. Enver Hoxhaj. Akuza të shumta hidhen vazhdimisht në drejtim

të dinamikës së diplomacisë kosovare, duke e quajtur e ad-hoc, inerte dhe joaktive.

Një nga situatat më groteske ishte ajo e muajit prill, në të cilën pati një përplasje mes zëvendëskryeministrit Behgjet Pacolli dhe ish-kryediplomatit Skënder Hyseni në Komisionin Parlamentar për Punë të Jashtme, lidhur me numrin e njohjeve. Pacolli këmbëngulte se deri në atë kohë Kosovën e kishin njohur 96 shtete, jo 99 nga sa deklaronte ministri i jashtëm, Enver Hoxhaj, pasi tre shtete nuk e kishin bërë ende “de juro” njohjen e saj. Në anën tjetër, Hyseni ngriti akuzën se dy anëtarë të Këshillit të Ministrave nuk bien dakord mes tyre sesa është numri i vërtetë i njohjeve të Kosovës.

Anëtarësimi në OKB

Që të merret në shqyrtim kërkesa e Republikës së Kosovës për t'u anëtarësuar në Organizatën e Kombeve të Bashkuara duhet që të njihet nga të paktën dy e treta e shteteve anëtare të saj, pra nga 129 vende nga 193 sa ka gjithsej. Anëtarësimi në OKB do t'i jepte mundësinë shtetit të ri të përfaqësohej edhe në organizmat e tjerë ndërkombëtarë, jo vetëm të karakterit politike-ekonomik, por edhe të rrafshve të tjera. Kjo procedurë mund të anashkalohej vetëm në rast se Këshilli i Sigurimit të OKB-së t'i paraqesë kërkesën e anëtarësimit për votim Asamblesë së Përgjithshme, pas relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm. Procedura e dytë është e pamundur në rastin e Kosovës, për shkak të kundërshtimit të njohjes së saj nga Rusia dhe Kina, të cilat janë anëtare të përhershme të KS-së dhe kanë të drejtën e vetos.

Për të arritur numrin e nevojshëm të njohjeve, shtetit më të ri të Evropës i duhen gati edhe tre vite të tjera, gjithmonë nëse do të ruajë intensitetin deritanishëm të njohjeve. Për këtë, diplomacia kosovare vazhdimisht ka tentuar të zbatojë strategji të reja në përshtatje me situatat e krijuara, por sërish kemi ngecje. Në fokus janë pesë shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, të cilat nuk e kanë njohur ende, si dhe organizimi i një fushate intensive lobuese në Afrikë, në Amerikën Qendrore dhe latine, si edhe tek shtetet arabe. Siç shihet edhe në hartën përbri (të vendoset harta që disponohet me vendet që kanë njohur Kosovën), vendet me ngjyrë gri që nuk kanë njohur ende Kosovën janë kryesisht të përqëndruara në kontinentet e sipërpërmendura.

Programi qeverisës për vitet 2011-2014


Vetëm në një pikë të tij përmendet shkurtimisht se qeveria do të angazhohet për vazhdimin e procesit të njohjeve ndërkombëtare të shtetit të pavarur dhe sovran. Është paradoksale që njohja e vendit të përmendet shkarazi në programin qeverisës, ndërkohë që ky duhet të ishte një nga prioritetet e këtij mandati.

Qeveria duhet të kishte një strategji dhe plan veprimi të detajuar, i cili të ishte më transparent për qytetarët. Ndërkohë, anëtarët e kabinetit qeveritar duhet të raportojnë më shpesh para Kuvendit për ecurinë e njohjeve të vendit dhe të ketë një bashkërendim të nismave që do të ndërmerren.

Faqja zyrtare “harron” të përditësohet

Duket se edhe vetë Këshilli i Ministrave nuk e ka marrë seriozisht çështjen e njohjeve të shtetit, pasi të dhënat mbi vendet që e kanë njohur Kosovën nuk janë përditësuar që prej nëntorit të vitit të kaluar. Sipas Portalit Shtetëror të Republikës së Kosovës, shteti i fundit që ka bërë njohjen e vendit është Sait Kitts dhe Nevis, dhe kjo ka ndodhur më 28 nëntor 2012.

Ndërkohë, që prej asaj date, e cila korrespondon me 100-Vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, Republikën e Kosovës e kanë njohur zyrtarisht edhe tetë vende të tjera. (Parë për herë të fundit (18 tetor 2013): <https://www.rks-gov.net/sq-AL/Pages/ShtetKaneNjohurKosoven.aspx>)





Elbasani, qyteti që po vdes nga industria



Rruga e vjetër Tiranë - Elbasan dallohet për kthesat e saj të shumta, por që të servir pamje piktoreske dhe çlodhëse gjatë gjithë udhëtimit: Male që ngrihen mbi male, gjelbërim i gjithanshëm dhe ajër i pastër. Gjatë gjithë rrugës, syri qetësohet nga pamjet që të ofron natyra shqiptare, por kjo zgjat deri në momentin që i afrohem Elbasanit, i cili prej së largu duket si i rrethuar dhe i mbytur nga një mjegull që asnjëherë nuk lëviz prej këtij qyteti.

I afrohem më shumë qytetit, deri sa krijojmë një vështrim më të qartë të tij dhe krahinave përreth. Pamja e parë që na serviret është gjysma e një qyteti të shkatërruar dhe në gjysmën tjetër ndërtesa të shumta, ku vazhdon normalisht jeta. E vetmja gjë e përbashkët që kanë këto dy botë është se janë nën mbretërinë e tymit, që është kthyer në shoqëruetin e jetës së përditshme të banorëve.

Ndalemi në komunën Bradashesh. Ajo përfshin në tërësinë e saj edhe Kombinatin Metalurgjik.

I pari qytetar që na del përpara, me trup mesatar, flokë të zinj, me një bluzë të bardhë, nuk kërkon të prononcohet, por duke u larguar, thotë: “Nëse doni të mësoni mbi ndotjen në Elbasan, nuk kanë ç’ju duhen fjalët e mia, por ngjituni në Kërrabë dhe do të shikoni se çfarë bëhet këtu. Fjalët e mia janë të tepërta, shkoni shikoni atje!”

Më pas takojmë Jeton Shaqirin, banues në zonën pranë Kombinativ Metalurgjik. Jetoni, tepër i tensionuar mbi

problematikën e ndotjes na lë të kuptohet se gjendja aktuale e ndotjes është serioze. “Natën nuk funksionojnë filtrat, vetëm ditën funksionojnë, sepse ka kontrolle. Ndërsa natën nuk bëhet fjalë të ndizen. Lajmë rrobat në darkë dhe kur ngrihem në mëngjes i gjejmë të bardhat të zeza. Këtu nuk bëhet më gjë, këtu ka vdekur çdo gjë”- përfundon Jetoni.

Duke vazhduar rrugën për tek Kombinati Metalurgjik, na bën përshtypje një burrë rreth të 50-ve, ulur nën hijen e një peme, i menduar dhe i ngrysur në fytyrë. Ndalojmë për ta pyetur se sa shqetësues është problemi i ndotjes në Elbasan. Në momentin që e pyesim, fytyra e tij ngryset edhe me shumë dhe ul kokën, për disa çaste nuk flet. “Vetëm tym ka këtu, vetëm tym, po vdesim, kemi helm në gjak, kemi hallin e fëmijëve, sepse s’po pyesim më për veten” -prish qetësinë burri flokëprishur dhe i thinjosur. Pastaj ngrihet dhe ikën, duke mos thënë emrin e tij, por në vend të emrit thotë: “Nuk ke çfarë e do emrin tim, më mjaftojnë hallet që kam, aman”

Arrijmë tek Kombinati Metalurgjik, futemi brenda dhe ndalemi tek dera e kompanisë “Kurum”. Ajo administron ish-gjigantit e dikurshëm dhe krenarinë e regjimit. Por më kot, drejtuesit nuk pranojnë të prononcohen për problemin e ndotjes.

Përveç pjesëve që janë dhënë me koncesion, ku dhe firmat përkatëse kanë investuar në infrastrukturë dhe në përmirësimin e kushteve të punës, pjesa tjetër e Metalurgjikut përbëhet nga gërmadha, i cili i ngjan një qyteti të shkatërruar. Këto pjesë të Metalurgjikut shërbejnë për të papunët e zonave përreth, të cilët kalojnë ditën duke nxjerrë skrap, për të mbajtur familjet e tyre. “Nuk kam ku të punoj, s’ka punë, s’kemi të ardhme, detyrohem të mbledh skrap, të piqem në diell çdo ditë për të siguruar bukën e fëmijëve të mi”- thotë një tjetër person, i cili nuk kërkon të identifikohet, sepse sipas tij mund t’i hapen probleme. “Jo, jo, emri im s’ka ndonjë rëndësi, sepse si dihet çfarë bëhet, jemi në një vend të vogël këtu, njihen të gjithë”

*“Vetëm tym ka këtu,
vetëm tym, po
vdesim, kemi helm
në gjak, kemi
hallin e fëmijëve,
sepse s’po pyesim
më për veten”*

*“Natën nuk
funksionojnë
filtrat, vetëm ditën
funksionojnë,
sepse ka kontrolle.
Ndërsa natën nuk
bëhet fjalë të
ndizen. Lajmë
rrobat në darkë
dhe kur ngrihem
në mëngjes i
gjejmë të bardhat
të zeza. Këtu nuk
bëhet më gjë, këtu
ka vdekur çdo
gjë”*

Nga larg, shikojmë punëtorët e firmës “Kurum” të dalin nga puna, kokulur, të ngrysur, të lodhur nga monotonia e së përditshmes dhe të pazakontës. Për ta është kthyer në një gjendje të zakonshme. Ata duhet të mbajnë gjallë dëshirën për të jetuar, duke sakrifikuar veten, të vetmen gjë që iu ka mbetur.

Në një marrëveshje fjale, për të mos përmendur emra konkretë, kontaktuam punëtorë të firmës “Kurum”. I pari, një burrë i moshës 45-50 vjeç, thotë se filtrat fiken zakonisht. “Nëse filtrat janë në punë, harxhohet sasi e madhe energjie elektrike”- shpjegon ai. Personi në fjalë pasi ktheu dy herë kafën e marrë, ia nis: “Çunat e rinj e kanë helmin në gjak, lëre më ne që kemi më shumë vite pune.



Në rastet kur bëjmë analizat dhe atyre të cilëve analizat u dalin keq, përzihen nga puna, kështu që ne nuk i tregojmë ose nuk i bëjmë analizat, sepse duhet të mbajmë familjet gjallë! Ai rrëfen duke iu dridhur zëri. Fliste jo duke të parë në sy, por duke përqendruar shikimin diku, sikur po tregonte ndonjë histori imagjinare dhe jo diçka reale, sikur po mendohej të depërtonte ndër vite, sikur kishte shumë gjëra për të thënë që ose nuk dinte nga t’ia niste ose kishte frikë të tregonte.

“Po sindikata?” – i thamë. Qeshi me ironi. Ishte e vetmja buzëqeshje që morëm gjatë gjithë takimit që patëm. “Sindikatat janë për të qenë, por që nuk funksionojnë fare, sepse drejtuesit e sindikatës janë nënshtruar duke u paguar nga përfaqësuesit e firmës”. Bëhet sërish serioz, ngulit sytë diku përsëri dhe ia nis: “Rreth 70 % e punëtorëve aty, janë me sëmundje profesionale dhe punëtorët të cilët kanë mbi 10 vite punë, janë 100 % të sëmurë.”

“Jeni të kënaqur me pagat?”- i thamë. Ngre zërin dhe merr një qëndrim prej njeriu të nxehur dhe më shikon në sy, për të parën herë: “Çfarë të kënaqur! Trajtohem ndryshe nga punonjësit turq. Për të njëjtën punë, ne (shqiptarët) marrim 40 mijë lekë, ndërsa ata (turqit) marrin dhjetëfish më shumë se ne”. Pastaj qetësohet dhe nxjerr nga xhepi paketën e cigares. E përshëndesim për kohën që na mundësoi dhe e lemë këtë person përsëri me shikimin e tij të përqendruar diku, duke treguar se heshtja është ngushëllimi i problemeve të mëdha.

Pas tij, shkojmë takojmë një punonjës tjetër të “Kurumit”, i cili nuk pranon kurrsesi që emri i tij të përmendet. Është fjalëpak, mesoburrë, flokëzi, me sy kaf që nuk dukeshin aspak të qetë dhe frika në atë çfarë thoshte dukej qartë.

-“ Si organizohet për ju një ditë pune ?” – i thamë.

- “Zakonisht, materialin (skrapin) e bëjmë gati ditën dhe e punojmë natën, duke qenë se natën punohet edhe pa filtra, në mënyrë që mos harxhohet shumë energji. Aty luan leku i madh, por ne punëtorët jemi skllevër, sepse kemi diskriminim në pagë. Sindikata është jofunksionale dhe çfarë do problemi që kemi s’na e merr njeri parasysht.”

Kaq na thotë punëtori i “Kurumit” dhe nxiton të ikë pa e nisur akoma kafën që kishte marrë, sepse ashtu e ka një punë, dhe e vetmja porosi që na lë është: “Të lutem vëlla, vetëm emra mos përmend se na flakin në rrugë”

//////

*“Kur
bëjmë analizat dhe
atyre të cilëve
analizat u dalin keq,
përzihen nga puna,
kështu që ne nuk i
tregojmë ose nuk i
bëjmë analizat, sepse
duhet të mbajmë
familjet gjallë”*

//////

Për autoritetet, situata është në rregull

Por edhe pse banorët e zonës ndjehen tepër të shqetësuar nga ndotja, që sipas tyre i shkakton kombinati, duket se një realitet i tillë nuk ekziston të paktën në dokumente zyrtare. Madje, matjet sipas autoriteteve paraqesin një nivel ndotjeje brenda normave të lejuara.

“Matjet aktuale të survejimit të vitit 2013 në zonën e ish-Kombinatit Metalurgjik, brenda dhe jashtë territorit të tij, rezultojnë përgjithësisht në vlera të grimcave të imta PM 10, brenda normës së lejuar në vendin tonë, por mbi atë të lejuar në vendet e Bashkimit Evropian për ajrin e zonave të banuara”- theksohet në raportin e Agjencisë Rajonale Mjedisore të Elbasanit për matjet e kryera gjatë muajve mars dhe prill të këtij viti.

Ndotja nuk është thjeshtë një perceptim i banorëve të zonës, ajo përkthehet edhe në kosto financiare dhe për më tepër, jetë të humbura për shkak të sëmundjeve të rënda.

Doktoresha e sëmundjeve të sistemit të frymëmarrjes në QSUT, Anila Kristo shpreh gjithashtu shqetësimin për një numër

në rritje të pacientëve me sëmundje që vijnë nga ndotja. “Elbasani, Vlora, Tirana dhe Fieri janë qytetet me prurjet e pacientëve më këto lloj problemesh/ Numri i personave me këto sëmundje vitet e fundit ka ardhur duke u rritur. Me këto sëmundje janë identifikuar edhe të rinj dhe këta kanë qenë kryesisht punonjës minierash dhe metalurgë”- shprehet ajo.

Kjo është situata në qytetin e Elbasanit. Një situatë që paraqitet nën kontroll nga ARM-ja dhe problematike nga banorët e zonave përreth. “Një gjë është e sigurtë, kjo situatë ka vazhduar kështu prej vitesh, dhe nëse nuk vihet dorë nga shteti, do të vazhdojë kështu”- thonë banorët e qytetit të Elbasanit.

Ngritja e industrisë, strategjia e sistemit komunist për të shpëtuar nga varësia për lëndë të parë nga shtetet “armike” është kthyer tashmë në një rrezik real për dhjetëra mijëra banorë që jetojnë në zonën përreth. Dikur, Metalurgjiku ishte shpëtimi për Elbasanin, tani po e vret atë çdo ditë.

Në komunën më të pasur në Shqipëri

Të gjithë mund të kenë dëgjuar për Bradasheshin, si komuna më e madhe në vend. Ajo ka një popullsi prej rreth 13 mijë banorësh dhe përbëhet nga 17 fshatra. Kjo komunë arrin të vjelë rreth 45 milionë lekë taksa në vit nga industritë e rënda që ushtrojnë aktivitetet në territorin e saj. Nga të dhënat mësohet se kompania “Kurum” i paguan kësaj komune rreth 30 milionë lekë në vit, kurse ACR-ja i paguan 15 milionë lekë në vit.

Të ardhurat e kënaqshme i mundësojnë komunës që të investojë në infrastrukturë si, rrugë, kanalizime dhe shkolla, duke përmirësuar jetesën e banorëve.

Një pjesë e këtyre parave duhet të shkojnë edhe si kompensim direkt financiar te banorët për ndotjen e shkaktuar.

Por, ky kompensim as nuk dihet çfarë është nga banorët e zonës. Këtë na e vërteton një banor tjetër i kësaj komune, të cilit edhe 20 mijë lekë që përfitonte nga Komuna Bradashesh nuk i merr më. Arsyen nuk e ka mësuar ende. “Komuna edhe 20 mijë lekë të vjetra që merrja m’i hoqi. Tani punoj për të nxjerrë skrap. Nuk kam çfarë të bëj tjetër. Fëmijët që kam në shtëpi duan të hanë dhe nuk pyesin jep apo nuk jep komuna, ka apo nuk ka punë, kështu që jam i detyruar të punoj për të nxjerrë bukën e gojës. Akoma nuk e di se pse unë nuk i marr akoma ato para, por kjo është e padrejtësi”- na tregon ai, i cili si gjithë të tjerët kur bëhej fjalë për emra, nuk dëshiron të identifikohet.

Një banor tjetër, shitës në këtë komunë, kur e pyesim sesa i kënaqur është për investimet e

bëra nga komuna, na përgjigjet me një zë të fortë: “Kush jeni ju?” “Student gazetarie” - i them unë. –“Këtu çdo gjë është në rregull, s’kemi ankesa, çdo gjë shkon shumë mirë - ma kthen. – Nuk kam çfarë të shtoj më, ju lutem më lini të punoj tani!” Duke lënë këtë njeri që tregohej mjaft i kujdesshëm në të folur, dalim përsëri të takojmë njerëz, që çuditërisht sapo merrnin vesh që kishin të bënin me median, largohen.

Kjo është komuna më e pasur në Shqipëri, një komunë në të cilën investimet nuk mungojnë, por që investimi më i madh akoma nuk është marrë: investimi i shpëtimit të banorëve nga tymi mbytës që i shoqëron ata në përditshmëri.





Tre dimensionet e komunikimit

Askush nuk e ka vënë ndonjëherë në dyshim rolin domethënës të komunikimit në një shoqëri. Të gjithë në një farë mënyre i nënshtrohen një konsensusi për sa i përket kësaj teme. Problemi fillon të pluskojë në sipërfaqe kur bëhet fjalë për aktualizimin e këtij komunikimi në përditshmërinë tonë. Njeriu është në thelb një qenie komunikuese, synimi i të cilit është të përcaktojë dy ekstremet e komunikimit: burimin dhe marrësin e tij. Përbërësi i tretë i komunikimit, shumë i rëndësishëm, është mesazhi komunikues. Mesazhi lidh burimin nga fillon komunikimi me fundorin në të cilin ky mesazh do të dërgohet. Njeriu është i dizenuar si qenie komunikuese, të cilit i është taksur një detyrë shumë e rëndësishme në ndërtimin e arkitekturës komunikuese.

Kjo arkitekturë komunikuese shtrihet në një marrëdhënie trekëndore: dimensionin e komunikimit të brendshëm apo metafizikës së komunikimit, dimensionin vertikal të marrëdhënies së tij me Zotin dhe në dimensionin horizontal. Ky i fundit ekspozohet në formën e marrëdhënies me shoqërinë apo të ndërtimit të komunikimit kolektiv.

Dimensioni metafizik i komunikimit ka në thelb shpirtin. Shpirti është një qenie intelektuale, me anë të së cilës intelektualitetin e vet e aktualizon dhe e perfeksionon në sajë të raporteve të veta



me dijen. Pikërisht përmes këtij intelekt, shpirti i njeriut arrin nivele superiore përmes procesit të eksplorimit të dijes e cila e përthyer në marrëdhëniet me trupin njerëzor, përbën atë njësinë qendrore të formulimit të mesazhit komunikues që zanafillon së brendshmi, për t'u shtrirë së jashtmi pastaj në marrëdhënien vet horizontale me shoqërinë. Komunikimi i brendshëm i qënies njerëzore, si pasojë e këtij procesi, finalizohet si elementi bërthamor i procesit komunikues. Më pas, në substancën e vet, ai mund të ndahet në dy pjesë: si bërthamë e

komunikimit të brendshëm dhe si mendim i projektuar në shoqëri. Që një individ të gëzojë një komunikim të shëndetshëm në raportet e veta horizontale, do t'i duhej të stabilizonte një komunikim po aq të shëndetshëm së brendshmi me veten e tij, përmes atributit të cilin e gëzon vetëm ai: përmes vetëqortimit dhe vetëpërmirësimit permanent.

Në dimensionin vertikal të komunikimit të individit me Zotin, elementi thelbësor është përqendrimi te zemra. Tashmë, jo si një organ "i banalizuar" në formën e një pompe gjaku, por në zemrën metaforike të



meditimit dhe të ndjenjave. Ky dimension pasurohet nga atributi i Krijuesit që të ndërhyjë mes njeriut dhe zemrës së tij, duke influencuar direkt në komunikimin transhendent të individit. Edhe pse shumë njerëz nuk e pohojnë ekzistencën e një dimensionit të tillë komunikues, kjo nuk i përjashtëson ata nga një kategorizim i tillë. Vetëm se ata nuk janë të ndërgjegjshëm për ekzistencën e këtij komunikimi. Nga ana tjetër, marshimi ynë i brendshëm drejt diturisë na afron gjithmonë e më tepër me të vërtetën, e cila është një shteg i pashmangshëm drejt Zotit. Zoti është vetë e vërteta dhe sa më shumë dije marrim, aq më afër Tij jemi. Sa më në raporte të drejta të jetë komunikimi ynë i brendshëm, aq më i stabilizuar dhe më i mirë do të jetë komunikimi ynë ndërpersonal me shoqërinë. Sepse zanafillën e tij veprimi komunikues e ka pikërisht te komunikimi i brendshëm, tek mendimi si fillim i aktit komunikues.

Komunikimi ndërpersonal apo

komunikimi horizontal është ndarja e ideve përmes dy a më shumë personave, në përpjekje për të thjeshtësuar procesin e të kuptuarit të ndërsjelltë. Gjatë këtij procesi realizohet shpërndarja e informacioneve dhe e fakteve. Por, ajo që është më e rëndësishme është përhapja e vlerave. Ky tip komunikimi mund të realizohet në nivele të ndryshme: në komunikim grupi, në komunikim masiv, në komunikim ndërkulturor, në komunikim religjioz, në komunikim social-ekonomik, në komunikim politik etj. Ai realizohet përmes formave të ndryshme të të ndërkuptuarit dinamik: ne kuptojmë të tjerët dhe kërkojmë që të tjerët të na kuptojnë. Komunikimi ndërpersonal ndihmon në reduktimin e injorancës dhe uljen e pasigurisë mbi aktualitetin dhe në të njëjtën kohë, stabilizon fuqi dhe pushtet mbi poseduesin e informacionit. Pra, dimensionit horizontal i komunikimit, i marrëdhënies sociale të individëve merr udhë duke u bazuar në një konsensus për realitetin që na rrethon. Ai është dimensionit

fundor i komunikimit, i cili ka aftësinë të ndryshojë realitetin. Përmes komunikimit të përditshëm, ne mund të ndryshojmë, ta mirëmbajmë, ta plotësojmë dhe ta deformojmë realitetin.

Që një individ të gëzojë marrëdhënie të mirë komunikuese, duhet që t'i ketë të harmonizuara të tre dimensionet e tij komunikuese: me vetveten, me Zotin dhe me shoqërinë. Lënia e njërit nga këto dimensione jashtë veprimit komunikues të përditshëm shkakton anomalitë komunikuese, të cilat ne i hasim shpesh në përditshmërinë tonë. Prandaj, harmonizimi i këtyre dimensioneve përmes një procesi të vazhdueshëm e të pandërprerë përmirësues, do të sillte ndërtimin e një shoqërie mbi bazat e virtytit. Një shoqëri që di si të komunikojë me veten është e aftë të ndërtojë gjëra të mëdha dhe të ketë një aftësi shumë më të madhe vetërregulluese.



Nga Dr. Arjet Gega



Antibiotikët dhe rreziku i përdorimit të tyre pa kriter

Shoqëria njerëzore në përgjithësi dhe mjekësia u njoh me medikamentet antimikrobale që në fillim të viteve '40. Që nga ajo kohë mund të themi që kemi pasur luksin e përdorimit të tyre për trajtimin dhe kurimin e infeksioneve. Pa dashur të bëj një historik të antibiotikëve, mund të them që kam dëgjuar me shumë kureshtje tregimin e dr. Fasanella. Dr. Fasanella ishte pjesëtar i ekipit që me 14 mars 1942, administroi dozën e parë të penicilinës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pacientja ishte një nënë e re me septicemia streptokokale pas lindjes.

Pas kurimit të pacientes, mjekët mblodhën urinën e saj për të përfutur sërish penicilinë për pacientë të tjerë. Më pas, u zbuluan dhe u përdoruan Streptomocina, Kloramfenikoli, Tetraciklinat. Çdo dekadë, arsenali i antibiotikëve u pasurua me emra dhe klasa të reja. Për fatin tonë të mirë apo të keq, shumica e tyre kanë një profil favorizues pa shumë efekte anësore. Disponibiliteti dhe magnesia e efekteve sekondare në një farë mënyre solli zanafillën e problemeve që po jetojmë sot.

Antibiotikët u shndërruan në një klasë medikamentesh që mund të rekomandohet nga kushdo, pavarësisht nivelit të ekspertizës. Ato filluan të përdoren përherë e më tepër në mënyrë empirike, pa një indikacion dhe diagnozë të caktuar, shpeshherë bazuar në shumë pak evidencë. Kësaj kulture të gabuar iu shtuan edhe përdorimet profilaktike, sërish të pabazuara në asnjë lloj evidence. Së fundmi, përdorimi në shkallë të gjerë i antibiotikëve industriale në pulari dhe fermat e mishit bëri të mundur që i gjithë ekosistemi ku jetojmë dhe bioma e tij të ekspozohet ndaj antimikrobaleve.

Për fat të keq, ne harruam se sa i zgjuar dhe i egër është armiku me të cilin po luftojmë: mikrobet bakteriale. Sa herë që njerëzit zbuluan një antibiotik të ri, bakteriet zbuluan një rrugë të re rezistence ndaj tij. Shpeshherë, kjo rezistencë është e transmetueshme midis



*“Një gjë është e sigurtë,
rezistenca ndaj një
antibiotiku të caktuar
është e lidhur ngushtë
me sasinë e përdorimit
të atij antibiotiku në atë
klinikë, spital apo
komunitet”*



bakterieve të ndryshme. Një gjë është e sigurtë, rezistenca ndaj një antibiotiku të caktuar është e lidhur ngushtë me sasinë e përdorimit të atij antibiotiku në atë klinikë, spital apo komunitet. Pas viteve'80 u njohëm me stafilokoket rezistentë, si MRSA (Methicillin Resistant Staph Aureus), Enterokoket superrezistente si VRE (Vancomycin Resistant Enterococcus). Kjo për fat të mirë solli një sensibilizim dhe mobilizim të shoqërisë në përgjithësi dhe botës farmaceutike në veçanti. U morën masa izolimi dhe u zbuluan dhe zhvilluan antibiotikë të rinj nga këto superbakterie, të cilat i përkasin grupit të kokeve “Gram positive”. Kështu Linezolidi, Daptomicina, Sinercidi, Televancina dhe së fundi Ceftarolina u aprovuan për përdorim dhe i erdhën në ndihmë botës mjekësore në luftën kundër rezistencës së bakterieve të këtij lloji. Për fat të keq, vitet'2000 sollën rritjen galopante të rezistencës ndaj antibiotikëve edhe të bakterieve bacilare “Gram negative”. Shumica e tyre si p.sh.

E. coli dhe Klebsiella janë pjesë e florës enterike, gjithmonë e ekspozuar ndaj antibiotikëve. Rezistencës së tyre ndaj kuinoloneve, si Cipro, Aminoglikosideve, Gentamicina apo Bakrimes iu shtua rezistenca ndaj të gjitha penicilinave dhe cefalosporinave që njohim gjer më sot. Këto lloj bakteriesh të njohura si ESBL (Extended Spectrum Beta Lactamase Producers) sot zënë deri në 5% të bacileve “Gram negative” të izoluar në çdo spital në SHBA dhe Europën Perëndimore. Dhe si të mos mjaftonte kjo, vitet e fundit filluam të hasim edhe bacile si Klebsiella dhe E. coli, të cilat janë rezistente edhe ndaj karbapenemeve. Karbapenemetet janë një klasë antibiotikësh, të cilët konsiderohen si alternativa e fundit. Kur këto lloj superbakteriesh të njohura me akronimin KPC (Klebsiella Pneumonia Carbapenemase) shkaktajnë një infektion serioz, alternativat për kurim janë shumë të limituara, pothuajse zero. Është ironike të mendosh që njerëzit në këtë kohë të

ipadit dhe facebook-ut të vdesin nga mungesa e një antibiotiku efektiv.

Këto zhvillime katastrofale e bënë Shoqatën e Sëmundjeve Infektive të Amerikës (IDSA) të lëshonte një deklaratë SOS në 2005-ën, në të cilën ftonin të gjithë politikanët, autoritetet shëndetësore, mjekët dhe hulumtuesit dhe veçanërisht firmat farmaceutike për të luftuar dhe fituar betejën me këto bacile vdekjeprurëse. Që nga ajo kohë, për fat të keq nuk është provuar për përdorim asnjë antibiotik i ri dhe sërish edhe pas 8 vitesh gjendemi me të njëjtat armë përballë ESBL dhe KPC-ve. Zhvillimet pozitive u dukën më shumë në përpjekjet për minimizimin e përdorimit të antibiotikëve pa kriter, si rruga e vetme për të parandaluar rezistencën. Shumë spitale implementuan programe që kërkojnë aprovimin e një specialisti infeksionistë përpara se të përdoren antibiotikë të caktuar. Kësaj iu shtuan edhe sisteme auditimi që vazhdimisht kontrollojnë përdorimin e antibiotikëve gjatë shtrimeve

spitalore. Megjithëse këto masa ishin patjetër efikase në mënyrë lokale, globalisht gjendja vazhdon të jetë e mjerë. Kuptohet që në botën e sotme globale, kur lëvizja e njerëzve është e madhe, është pothuajse e pamundur të ruhes nga bakteriet rezistente të importuara. Kjo u pa qartë me bacilet NDM (New Delhi Metalloproteinase) që u importuan nga India në Angli dhe më gjerë në Amerikën e Veriut. Shembull tjetër shumë i qartë është importimi i bakterieve plurirezistente. Ato quhen Acinetobakter. Acinetobakter erdhën nga ushtarët amerikanë që shërbyen në Gjirin Persik.

Për fat të keq në vendet në zhvillim si Shqipëria, situata vazhdon të jetë krejtësisht jashtë kontrollit. Në vendin tonë, antibiotikët vazhdojnë të jepen pa recetë,

sipas tekave të pacienteve apo njohurisë së kufizuar të farmacistëve. Shpeshherë edhe në qendrat e mëdha shëndetësore, analizat mikrobiologjike mungojnë ose janë tejet të limituara. Ende vazhdon kultura e të marrit antibiotikë për çdo të tështirë apo kollitje pa u vizituar nga mjeku përkatës. Në një studim të bërë rishtas te pacientët me sinozit, 80% e tyre shkojnë në shtëpi me antibiotikë, ndërkohë që vetëm 20% kanë vërtet sinozit bakterial që meriton trajtim. Antibiotikët orale si Amoksicilina, Ciprofloksacina dhe simotrat e saj, Azitromicina dhe Klaritromicina, Baktrima apo Cefalosporinat janë medikamentet që shkruhen nëpër receta dhe merren më shumë nga pacientët e të gjitha moshave në botë. Përdorimi i tyre pa kriter do të na bëjë që t'i humbim këta antibiotikë

përgjithmonë dhe pa dyshim nuk do të kenë efekt kur me të vërtet kemi nevojë për ta.

Dëshiroja që ky shkrim të ishte një apel për të gjithë mjekët që minimizojnë përdorimin empirik dhe pa indikacion të drogave antimikrobiale te pacientët e tyre.

Gjithashtu duhet që të ndalohej rreptësisht me ligj shitja e antibiotikëve pa recetë. Pa dyshim, publiku i gjerë duhet të ndërgjegjësohet në këtë drejtim dhe të kuptojë që antibiotikët janë një luks që nuk duhet keqpërdoruar dhe humbur. Mënjanimi i marrjes së antibiotikëve pa kriter duhet të jetë detyrë e çdo individ apo prindi, sepse dëmi që bëhet është shumë i madh dhe i pandreqshëm.



“Azitromicina dhe Klaritromicina, Baktrima apo Cefalosporinat janë medikamentet që shkruhen nëpër receta dhe merren më shumë nga pacientët e të gjitha moshave në botë. Përdorimi i tyre pa kriter do të na bëjë që t'i humbim këta antibiotikë përgjithmonë dhe pa dyshim nuk do të kenë efekt kur me të vërtet kemi nevojë për ta”

Shënim: Autori i këtij shkrimi është mjek i sëmundjeve të brendshme në ST.Mary's Hospital, Waterbury, Connecticut



HËNA E PLOTË BEDËR UNIVERSITY

Në emër të vlerave!



Bachelor në

Drejtësi
Shkenca Komunikimi
Shkenca Islame
Gjuhë dhe Letërsi Turke
Gjuhë dhe Letërsi Angleze
Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji
Arsim Parashkollor dhe Fillor

Master në

Master i Shkencave në Drejtësi
E Drejtë Penale / E Drejtë Ndërkombëtare
Master i Shkencave në Shkencat e Komunikimit
Gazetari / Marrëdhëniet me Publikun
Master i Shkencave në Shkencat Moderne Islame
Master i Shkencave në Shkencat Themelore Islame
Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze
Master i Shkencave në Përkthim dhe Interpretim
Master Profesional në Mësuesi,
Gjuhë Angleze për Arsimin e Mesëm
Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe
Pedagogji
Master i Shkencave në Menaxhim Arsimor,
Planifikim dhe Zhvillim i Kurrikulës
Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Turke
Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Turke

Adresa: Rr "Jordan Misja", Tiranë-Shqipëri

Kontakt: Tel + 355 4 24 19 200 Cel :+355 67 34 27 00 e-mail: info@beder.edu.al

Nga Xhevahir Qardaku



Kthim mbrapa në kohë në burgun e Spaçit

Rreth orës 11:30 u nisëm nga Tirana drejt burgut famëkeq të Spaçit me një furgon të rastit, i cili i përket linjës së qytetit të Rrëshenit. Hipëm në furgon, përshëndetëm shoferin të cilin e quajmë Mark dhe u nisëm për në rrugëtimin tonë. Ndërkohë që lamë pas Tiranën, dolëm në Kamzën e mbushur plot me flamuj të partive politike të ndryshme, të cilët tregojnë se është lënë pas koha kur ekzistonte vetëm një flamur. Kaluam Kamzën e zhurmshme dhe arritëm në Fushë- Krujën e qetë. Hymë në kthesën

që të fut në Rrugën e Kombit, e cila na mundësoi një udhëtim të qetë dhe na mahniti me pamjen dhe bukurinë e natyrës së paprekur.

Filluam bashkëbisedimin me Markun dhe një pasagjer tjetër dhe i treguam rreth qëllimit të rrugëtimin tonë. Ata na rrëfyan se Spaçi është shpallur monument kulture dhe duhet të mbrohet nga shteti, por nuk ka roje që ta bëjnë këtë punë. Shkatërrimi i burgut të Spaçit është bërë gradualisht, pasi njerëz të papërgjegjshëm dhe në nevojë, për të siguruar mbijetesën e tyre

kanë prishur strukturat e ndërtesave dhe ua kanë marrë hekurat, të cilat i kanë shitur për skrap. Marku duke qeshur na tregoi për “Murin Kinez”, i cili ishte një mur i stërmadh pritës. Muri ishte ndërtuar si shkak i erozionit të malit dhe ka kushtuar 5 milionë euro.

Pa u vënë re, ndodheshim në qytetin e Rrëshenit, që është edhe qendra e rrethit të Mirditës. Marku thotë se Rrëshenin më përpara e kanë quajtur “Fushë-Lumth”, pasi ishte e vetmja zonë fushore në atë vend dhe sepse kishte afër lumin Fan i Vogël. Qytetarët e Rrëshenit duken njerëz të thjeshtë, bujarë dhe shumë të sjellshëm. Vazhduam rrugëtimin tonë nën petkun e kësaj bukurie natyrore, e cila na magjepsi me gjelbërsinë e saj, si edhe me majat e thepisura të maleve që e rrethojnë. Për njëzet minuta arritëm në një fshat të vogël të quajtur Reps, ku na pret udhërrëfyesi ynë.

Marku na shoqëroi deri te fshati Reps ku do të takoheshim me z.Tonin Tusha, sepse, Markut i duhej të largohej dhe të vazhdonte punën e përditshme. U përshëndetëm me Markun dhe u takuam me Toninin, i cili është një banor i zonës dhe një ish-punonjës i minierave të Spaçit. Tonini kishte filluar punën si praktikë në minierat e Spaçit në vitin 1981, fill pas mbarimit të shkollës së mesme.

Hipëm në makinën e Toninit dhe morëm rrugën drejt rrënojave të mbetura





nga burgu famëkeq i Spaçit. Pikërisht në këto momente filloi shkëputja jonë nga normaliteti i kësaj epoke dhe kthimi pas në kohë, pasi çdo gjë që ndodhej në atë vend i përket periudhës së viteve 1968-1995. Aty na ra direkt në sy zverdhja e gurëve të lumit Fan i Vogël. Pyetëm udhërrëfyesin tonë. Ai na tha se uji i lumit nuk mund të përdoret as për pirje dhe as për vaditje, sepse uji përbëhet nga njëlojë acid që rrjedh nga mali dhe kjo është arsyeja pse gurët janë të zverdhur. Kjo duket sikur të dënuarit e Spaçit e kanë mallkuar atë zonë dhe lotët e tyre janë shndërruar në acid, që të tregojnë vuajtjet dhe dhimbjet e tyre në atë kohë.

Burgu famëkeq e ka zanafillën e vet në vitin 1951 në Peqin dhe jo në fshatin e Spaçit. Ai u formua si një grup të burgosurish që i dërgonin në fronte të ndryshme pune, pra ishte si një burg shëtitës. “303” kështu do të emërtohej burgu më famëkeq në Shqipërinë e diktaturës. Puna e parë e zhvilluar nga “303” ka qenë kanali vaditës Peqin-Kavajë. Ndërsa në prill të vitit 1968, pas mbarimit të ndërtimit të fabrikës së çimentos në Elbasan, ata do të transferoheshin për në vendqëndrimin e përhershëm, në fshatin e Spaçit. Vendi u zgjodh nga Kadri Azbiu dhe kryeministri i asaj kohe, Mehmet Shehu. Ndërtimi i burgut fillestar, si rrethimi dhe barakat është bërë në janar – prill 1968

nga të dënuarit “ordinerë”. Ndërtimet e tjera brenda kampit si godinat, magazinat, etj. janë bërë nga të burgosurit politikë kohë pas kohe.

Drejtori i Drejtorisë së Arkivit të MB, kryetari i Arkivit të Sistemimit, historiani i njohur Kastriot Dervishi u mundua të na ndihmoi pak me shifrat e të dënuarve dhe të viktimave. Ai shprehej se nuk ka të dhëna të sakta se sa ka qenë numri i (përgjithshëm) i të dënuarve dhe i viktimave, sepse nuk ekziston ndonjë arkivë për këtë çështje, por nga bisedimet me shumë të burgosur (dhe të dhënat që kemi mundur të gjejmë) kishte arritur

në shifrën mesatare 700 persona në vit. Kapaciteti i dy godinave ka qenë 762 persona, por në vitin 1977 aty kanë qenë 835 persona që kanë vuajtur dënimin. Në vitin 1980 aksidentohen 365 të burgosur ku 1 person gjen vdekjen dhe plagosen 12 të tjerë. Një e dhënë e çuditshme është për vitin 1990 ku rezltonin vetëm 46 të burgosur sepse ishin transferuar në burgje të tjera, ndërsa një pjesë ishin falur me amnistinë e vitit 1989. Me 19 qershor të vitit 1990 shpërndahen nëpër burgje të tjera të gjithë të dënuarit politik dhe në vitin 1995 burgu mbyllet.

Udhëtimi ynë përkoi fiks me 40-vjetorin e revoltës së Spaçit, ku të dënuarit tentuan të bënin kryengritje duke valvitur flamurin shqiptar pa yll në godinën e burgut por pa rezultat, e vetmja gjë që fituan qe rritja e dënimit. U afruam drejt një tabele shumë të vjetër, e cila na tregoi dy drejtime, njëri kodrën Spaç dhe tjetri Gurth Spaç. Pasi kaluam këtë tabelë, Tonini na tregoi për vendin ku varrosen dhe mënyrën e varrosjes së viktimave, të cilët nuk ia arrinin të dilnin gjallë nga galeria. Ai rrëfen se trupat e pajetë nuk dorëzoheshin në familjet e tyre. Dy ushtarë dhe dy të dënuar bënë hapjen e gropave, transportin dhe groposjen e trupit të pajetë. Tonini tregoi se çdo herë që binte shi, kockat e viktimave rrëshqisnin dhe



binin në lumë.

Ashpërsia e terrenit gradualisht filloi të rritej dhe na u shfaq një pamje e zymtë, si edhe koha e cila bëhej e vrenjtur. Më në fund arritëm të hyrja e burgut të Spaçit. Sipër ishte vendi i rojes. Në krah të djathtë ishte depoja e lëndëve plasëse. Në krahun e majtë ishte Fjetina e Punëtorët të Lirë. Pak më sipër ishte vendi ku jepej qumështi falas për të dënuarit dhe punëtorët e lirë. Tonini na tha se këtu ka patur dy kampe: Kampi Ordiner, ku vuanin dënimin ata persona që nuk kishin bërë veprime kundër regjimit. Ndërsa kampi tjetër quhej Kampi Politik dhe aty përfundonin të gjithë të dënuarit politik. Ai na tregoi edhe për repartin e jabanxhinjëve korçarë, të cilët kishin ushqim komplet të ndryshëm, sepse ata hanin gjëra që ne nuk i hanim, si p.sh. bretkosa.

Një dëshmi tronditëse e Toninit ishte rreth vendit të quajtur Zona 2, ku nxirrej një mineral i veçantë që quhet Pirit dhe kishte formën e rërës. Aty punonin vetëm të dënuarit. Tonini thotë se propabiliteti për të dalë gjallë nga ajo zonë ishte shumë e pakët, sepse kur plaste eksplozivi, sasi të mëdha Piriti binin duke zënë poshtë shumë të dënuar. Ai na tha se të dënuarit që e dinin se do të transferoheshin tek Zona 2 vendosnin eksploziv tek dora ose tek këmba e tyre, kthenin kokën në anën



tjetër dhe e shpërthenin, në mënyrë që të shpëtoni veten nga vdekja e sigurtë.

Vazhduam rrugën. Arritëm te vendqëndrimi i rojes tjetër si dhe i shtabit drejtues. E kaluam atë dhe dolëm në vendin e quajtur "Pushimi i 5-Minutëshit", ku gjatë këtyre 5 minutave nuk bëhej pushim, por për 30 metra bëhej vrap vajtjeardhje në mënyrë të vazhdueshme. Këtu bëhej shpërndarja e të dënuarvë sipas zonave. Vazhduam më tej dhe arritëm në një vend ku quheshin Biruca. Ishte vendi ndëshkimor ku qëndronin të burgosurit dhe kishte një madhësi një me një. Birucat ishin vendet ku vuhej dënimi për thyerje disiplinore, për mosrealizimin e normës së punës etj. Birucat mbanin brenda 2,

por edhe 3 veta me raste. "Sa lotë janë derdhur në këtë vend vetem Zoti e di"- tha Tonini me një fytyrë të dëshpëruar.

Një herë në vit bëhej ndërrimi i kashtës së grurit të dyshekëve. Për këtë punë merreshin vetëm të burgosurit që sillleshin mirë, një ndër ta ishte dhe Sabri Koçi. Një vit, ndodhi kështu. Dyshekët u mbushën. Kamionët e ngarkuar me dyshekë dhe të burgosur u nisën drejt burgut, por vetëm kur arrijnë në Spaç, ata kuptojnë se kanë lënë Sabri Koçin te vendi i mbushjes së dyshekëve. Bëhet alarm i madh dhe sa u bënë gati të dilnin për ta kërkuar, panë Sabri Koçin duke ardhur vetë në drejtim të burgut. Ai e dinte se nuk kishte nga të shkonte dhe mendoi se mënyra më e mirë ishte të dorëzohej vetë, para se ta vrisnin.

"Në atë kohë ka pasur dy shtëpi afër burgut që jetonin familje. Ishte mëngjes dhe po dilja për në punë. Ndërkohë që pashë tre fëmijë, dy djem dhe një vajzë, vjen një roje me qenin e tij për dore. Qeni leh, vajza trembet dhe bie rrokullis nga 30 metra lartësi në një majë mali të thepisur. Unë ndalem dhe shkoj e kap atë vajzën në krahë dhe e çoj tek infermiera, e cila ishte mjaft e aftë, për të mos thënë që ishin mjekët më të zotë të asaj kohe. Vajza shpëton"- tregon udhërrëfyesi ynë.

"Këto janë rrënojat e Spaçit të famshëm"- na tha Tonini duke lëshuar një gurë në humnerë plot dëshpërim...





Nga Skënder Bruçaj

Identiteti “Online” dhe “Offline”

Besoj se ju ka rastisur të dëgjoni njerëz që krenohen se kanë me qindra miq në *Facebook* dhe në të vërtetë shumicën e tyre as që e njohin. Imagjinoni sikur fjala e urtë “më mirë një mik sesa një çiflig” të vlente edhe për miqtë e *Facebook*-ut, atëherë do të ishim shumë të pasur. Njeriu si qenie sociale ka nevojë të socializohet me të tjerët, ka nevojë ta duan dhe të dojë dhe normalisht ndjehet mirë kur merr me qindra “like” në fotot, komentet, statuset që poston në *Facebook*. Jemi me pushime me familjen në plazh dhe me ndihmën e “telefonave inteligjentë” që tashmë i kemi të gjithë, shfrytëzojmë rastin të postojmë një foto me rroba plazhi dhe menjëherë na vijnë 100 like nga miqtë e *Facebook*-ut. Krenohemi e na bëhet zemra mal, sidomos mbas disa komenteve si “yll bote... jeni të paparë”, menjëherë e ndiejmë veten vip.

Njerëzit që kur i hasim në rrugë as që e marrim guximin t’i përshëndesim, në botën virtuale iu hapim dyert e botës tonë private, i bëjmë pjesë të aktiviteteve, të gëzimeve dhe të hidhërimeve tona personale. Nuk dua të mohoj anë të pozitive që kanë rrjetet sociale, si *Facebook*, *Twitter*, *Myspace*, *Google+* etj, por jam pak i shqetësuar për faktin se mos po e teprojmë pak dhe mos na komandojnë rrjetet ne dhe jo ne ato. Sipas Social Baker-it, Shqipëria ka mbi 1 300 000 përdorues të rrjetit social *Facebook*. Pothuajse është gjysma e popullsisë shqiptare që

e përdorin këtë rrjet socila dhe ky numër na rendit në vendin e 60-të në botë nga numri i përdoruesve të *Facebook*-ut. Siç dihet, *Facebook*-u rekomandohet për individë mbi moshën 13 vjeç. Por, sa është përqindja e përdoruesve që janë nën moshën 13 vjeç? Sa nga këta fëmijë kanë disa llogari të hapura me emra të ndryshëm, një herë me emër mashkulli e pastaj me emër femre? Sa nga këta përdorues harxhojnë mbi 2-3 orë në ditë duke “lundruar” në *Facebook*? Ja vlen të mendojmë për përgjigjet e këtyre pyetjeve dhe ndikimin që kanë rrjetet sociale, ose më gjerë interneti tek fëmijët tanë, tek miqtë tanë, tek vetë ne. Sa më shumë kohë të harxhojmë si përdorues të rrjeteve sociale, aq më shume varemi nga ato dhe aq më pak kohë gjejmë të investojmë për miqtë e vërtetë. Është e lehtë të vendosësh një foto të një filxhani me kafe në *Facebook* dhe pastaj të bësh tag te të gjithë miqtë e tu virtual. Është e lehtë të ndash një gëzim me miqtë e tu virtual, por nuk do ta kuptosh se kujt i shkëlqejnë sytë më shumë. Është e lehtë të kesh shumë miq në *Facebook*, por sa nga ata do të kesh pranë në një ditë kur ke nevojë për një fjalë të ngrohtë, për një mbështetje të sigurtë. Ja vlen të investojmë më shumë për miqtë e vërtetë, për ata që na duan dhe na respektojnë ashtu siç jemi në të vërtetë në botën reale, në botën offline pa lajka.





Nga Borana Belegu




Pogradeci, aty ku edhe mali u dogj nga dashuria për liqenin

Vite-shumë stolat në parkun ku hapat e njerëzve thurin melodi me zhurmën e gjetheve të thata. Diku këngë zogjsh, diku mendimtarë të heshtur e diku tjetër fjalë që humbasin mes buzëqeshjesh miqësore. Shpirti gjen paqe aty, mes njerëzve që vargëzojnë mendimet dhe kërkojnë magjinë e perëndimit. Valët vizitojnë bregun vjedhurazi. Duket sikur kërkojnë të mbajnë shënim gjithçka ndodh përreth. Konkurojnë njëra-tjetrën. Kohës vraparake kërkojnë t'i ndalin vrullin për t'i thënë dy tri fjalë, ashtu, si në këngën pleqërishte që i djeg xhanin çobanit.

Për ata që nuk e njohin është

e lehtë ta përshkruajnë Pogradecin, sepse mjafton të hedhin në letër ndjesitë që u jep fakti i të qenit udhëtar në qytetin e luleve, por për ata shpirtëra vraparakë, të frymëzuar nga poemi lasgushian është vështirë të shkruhen fjalët sepse nuk dinë nga t'ia nisin. Zgjidhja mbetet të lënë penën të lirë. Le të shkruajë shpirti e jo më arsyeja. Sapo arrin në Qafë Thanë përpara shtrihet një peisazh që të lë pa mend. Gadishulli i Linit, perla që mirëpret mysafirët në Pogradec. Aty janë të pakëta banesat. Ato qëndrojnë gjithmonë e më pranë bregut e duket sikur meditojnë, plaken e rinohen, por nuk luajnë

////////////////////
“Përreth gjenden pyjet me dushk e gështenja dhe Mali i Thatë, për të cilin thuhet se ka mbetur i tillë i djegur nga dashuria për liqenin që s'mundi kurrë ta përqafojë, por vetëm ta ruajë e të bëhet ziliqar nga shikimet e panumërta”
 //////////////////////



prej vendit. Rojtarë besnikë të qetësisë që i bën të rinjtë të thurrin vargje nën dritën e hënës dhe pleqtë të psherëtitjës me nostalgjinë e viteve që vanë.

Sapo zbret qafen e Thanës, rrugëtimi vazhdon buzë liqerit derisa mbërrin në qytet. Aroma e kafesë së pjekur, vështrimet kureshtarë që kërkojnë të marrin vesh të rejtat më të fundit, gratë që thurrin triko e nuk lënë njeri pa marrë në gojë me atë theksin tipik, gjallëria qytetase me të gjitha karakteristikat e saj, në fund, të çon tek shëtitorja. Ndalesh për pak dhe pa kuptuar zemra fillon rreh më fort e shtohen frymëmarrjet, nuk dihet kush është fajtor. Perëndimi apo liqeri?

Dikur qyteti ka qenë në kodrën që tani është braktisur sepse liqeni u tërhoq dhe mori në gji edhe njerëzit, të dehur pas bukurisë dhe fshehtësisë së tij. Përreth gjenden pyjet me dushk e gështenja dhe Mali i Thatë, për të cilin thuhet se ka mbetur i tillë i djegur nga dashuria për liqenin që s'mundi kurrë ta përqafojë, por vetëm ta ruajë e të bëhet ziliqar nga shikimet e panumërta. Klima është paramalore dhe malore, me të katërta stinët. Kjo mundëson zhvillimin e turizmit të bardhë, të gjelbër dhe atij familjar. Banorët mirëpresin turistët në shtëpitë e tyre duke ndarë për ta një ose dy dhoma, sipas nevojës, kundrejt një pagese modeste.



Burrat përveç detyrave të tjera merren me përgatitjen e verës dhe me peshkim, ndërsa gratë merren me gatimet dhe punët e shtëpisë. Tradita mbetet e palëkundur. Në vjeshtë përgatiten zahiretë e dimrit, petkat, turshitë, perimet e thara etj.

Për të mësuar më tepër për qytetin mjafton të ecësh buzë liqenit, aty ku të moshuarit luajnë domino dhe kujtojnë vitet e shkuara, të rinjtë, grupe-grupe bëjnë xhiron e përherëshme. Nëpër lokale, që qëndrojnë radhë, njëri pas tjetrit, luhet muzikë live dhe i këndohet çupave. Pak më tutje shiten petulla e gështenja, piqen lakrorë në saç dhe gatuhet peshku në tavë.

Gjallëria nis të lodhet pas mesnate, atëherë qyteti fillon të pushojë pak, por tek-tuk ka dhe ndonjë pijanec që nuk i bën dot vetes derman dhe këndon për Hamidenë, të dashurën e zemrës së pijanecëve.

Dhe errësira nxiton të mbyllë qerpikët që të zgjohen herët për të mos humbur lindjen e diellit. Rrezet e para depërtojnë në luginën e thukët të malit dhe ftojnë qytetin të zgjohet. Liqeri reflekton larmishmërinë e ngjyrave, ai nuk fle, nuk harron të përkëdhelë begun.

Liqeri ka origjinë tektonike, moshë e tij është tre milionë vjeçare. Pika më e thellë është 297 metër, më i thelli


në Ballkan. Shqipërisë i takon vetëm 1/3 e sipërfaqes, pjesa tjetër i përket Maqedonisë. Ka formë vezake. Aty rriten lloje të ndryshëm peshqish si: Kleni, Belushka, Ngjala, Cironka etj. Karakteristik është Korani, i cili nuk rritet kundër tjetër përveçse në liqenin e Ohrit nga i cili buron edhe lumi Drin i Zi. Ndër shpendët që fluturojnë mbi liqen përmendim Guzën dhe Bilbil Gjyzarin.

Popullsia e Pogradecit shkon deri 40 mijë banorë ndërsa bashkë me rrethinat arrin 75 mijë banorë.


Turizmi ofron mundësi shumë të mira për zhvillimin ekonomik. Tushemishti dhe Driloni mbeten zonat më të vizituara, mrekulli të natyrës. Thuhet se aty prehen muzat. Driloni ka arritur të zbutë edhe zemra diktatorësh, aty Enver Hoxha kalonte pushimet e verës.

Të shkruash për qytetin e Pogradecit është kënaqësi më vete, por jo të gjithë munden ta përcjellin atë ashtu si është në të vërtetë. Do duhet ta vizitosh për të kuptuar realisht edhe shkrimet e Mitrush Kutelit dhe Lasgush Poradecit, pasuria e letërsisë qytetase, por edhe asaj kombëtare.

Një mbyllje e denjë mund të bëhet më mirë me poezinë që Lasgush Poradeci i ka thurrur Pogradecit të pashoq, aty ku shpirti bëhet një me ndjesitë.



Perëndim i vagëlluar mbi liqerin pa kufi,
Po përhapet dalë-nga-dalë një pëlhurë, si një hije.
Nëpër mal e nër lëndina shkumb'i natës që po bije,
Duke zbritur që nga qjelli, përmi fshat po bëhet fir...



E kudo krahin' e gjerë më s'po qit as pipëlin:
Në katund kërcet një portë... Në liqer hesht një lopatë...
Një shqiponjë e arratisur, fluturon në mal të Thatë
Futet zemra djaloshare mun në fund të shpirtit tim.

Tërë fisi, tërë jeta, ra...u dergj...e zuri gjumi...
Zotëroj në katër anët errësira... Po tashi...?
Duke nisur udhëtimin mes-përmes nër Shqipëri
Drini plak e i përrallshëm po mburon prej Shën Ndaumi.



Nga Hasan Bello



Fati tragjik i shkrimtarit dhe publicistit Petro Marko midis fashizmit dhe komunizmit

Petro Marko lindi në Dhërmi të Himarës më 25 nëntor 1913 dhe ndërroi jetë në Tiranë në fund të vitit 1991. Studimet e para i mori në vendlindje dhe në Vlorë ku pati drejtor arsimtarin e studiuesin Kolë Kamsi dhe mësues Ernest Koliqin. Në këtë shkollë jepnin mësim edhe shumë mësues italianë, njëri prej të cilëve e prezantoi me “Manifestin Komunist” të Marksit. Pasi kreu shkollën, sorollatet nëpër Tiranën e asaj kohe në kërkim të ndonjë pune, deri sa i bie në dorë një ditë Hilë Mosit, asokohe Ministër Arsimit, i cili e caktoi mësues në Dhërmi.

Më pas transferohet për në Dhuvjan të Dropullit. Qëndron në kontakt të vazhdueshëm me shtypin komunist nëpërmjet gazetave greke, të cilat ia jepte Asim Vokshi. Si pasojë e një ngatërrese që pati, u gjet pretexti se Petro Marko i jepte nxënësve literaturë komuniste. Kështu ai u detyrua të largohej për herë të parë në Greqi dhe të qëndrojë në Korfuz ku bie në kontakt me emigrantët politikë antizogistë me në krye dr.Omer Nishanin. Pastaj nisjet për në Athinë, ku kishte të vëllanë Dhimitrin që ishte larguar që fëmijë. Atje hyn në Fakultetin e Letërsisë, por përjashtohet pas një debati me rektorin të cilit Petroja i thoshte se *“turp për ju që ende jetoni në kohë të Bizantit!...”*, ngaqë ai e shikonte si turp që një

himarjot të ishte mësues i shqipës. Nëpërmjet punëdhënësit të së vëllait i krijohet mundësia të hyjë në një shkollë joshitetërore, në Fakultetin e Ekonomisë Politike. Shqyrton mundësinë të shkojë në Bashkimin Sovjetik, ku në atë kohë ishte edhe Sejfulla Malëshova, Ali Këlmendi e Tajar Zavalani, por bie poshtë si mundësi.

Kthehet në Shqipëri, por ikën fill pas dështimit të Kryengritjes së Fierit të vitit 1935. Rikthehet pas vendosjes të qeverisë liberale të Mehdi Frashërit në verë të vitit 1935. Më 1936 boton revistën “ABC” bashkë me Branko Merxhanin, Demir Godellin, Tajar Zavalanin dhe Migjenin, e cila u mbyll pas numrit të 2-të. E internojnë në Porto Palermo (2 javë) e pastaj në Llogara dhe lirohet me interesimin të Branko Merxhanit e të Et`hem Totos. Bashkëpunon në “Përpjekja shqiptare” të B.Merxhanit, që Brankoja donte ta vinte si antipod i “Hylli i Dritës”, por largohet mbasi Brankoja shkruan artikullin “Pse s`jam marksist”. Pasi në një gazetë tjetër del haptas me idetë e tij pro proletarietit, i bie halë në sy Ministrin të Punëve të Brendshme Musa Jukës, i cili për ta pajtuar i propozon postin e zv/prefektit në Himarë. Petro i jep fjalën se do ta pranojë pasi të shkojë në Athinë e të japë ca provime.

Takohet me Migjenin para se të



niset (1937) dhe pastaj me të mbërrirë në Athinë merr anijen për në Francë. Mbërrin në Marsejë dhe gjen në Paris Llazar Fundon e Ali Kelmendin, për t'u bashkuar më pas me vullnetarët e brigadës "Garibaldi" që luftonin në Spanjë kundër vendosjes së regjimit fashist të Frankos. Pas kthimit në atdhe, në Vlorë nis e harton trakte shqip e italisht kundër fashizmit, gjë për të cilën e burgosin në Vlorë, Tiranë dhe në mars të vitit 1942 e internojnë në Itali. Pas çlirimit të jugut të Italisë nga forcat aleate anglo-amerikane çan burgun së bashku me të burgosur të tjerë dhe kalon në zonat e çliruara italiane. Më 1944 arrestohet nga gjermanët dhe po atë vit në përfundim të Luftës Antifashiste kthehet së bashku me 300 shqiptarë të tjerë në Shqipëri.

Edhe pse krijues e njeri me merita të veçanta, pas një kohe të shkurtër si kryeredaktor i gazetës "Bashkimi", ai do të përfjetojë burgosjen e regjimit komunist (maj 1947 - maj 1950) si dhe fyerje e peripeci të pamerituara siç është çensurimi i veprave, ndalimi i botimit, përjashtimi nga Lidhja e Shkrimtarëve, mënjanimi nga jeta publike, burgosja e të birit për agjitacion e propagandë etj.

Në vitin 1978 kur u botua "Historia e letërsisë shqiptare e realizmit socialist" nga Insituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, gjëja e parë që binte në sy për keq ishte mungesa e emrit dhe e veprës së shkrimtarit më produktiv të asaj kohe Petro Marko.

Në vitin 1984, - shkruan redaktoria Frida Idrizi - "kisha përgatitur një antologji të tregimit shqiptar, ku kisha përfshirë autorët më të mirë që nga fundi i shekullit të kaluar e deri në vitet 30-të dhe e dorëzova për botim në shtëpinë botuese "Naim Frashëri". Natyrisht që në antologji kisha futur edhe tregime të Petros... Por antologjia u fut në shtyp pa tregimet e Petro Markos. Në fillim u hoq fotografia dhe vlerësimi që i bëja në parathënien e antologjisë. Unë kundërshtova. Ishte një fyerje e madhe, diçka absurde që vetëm ai të ishte pa fotografi dhe pa vlerësim. Pas një debati të gjatë, drejtorja e shtëpisë botuese ia kaloi problemin Drejtorisë së Shtypit pranë KQ të PPSH. Vendimi erdhi shumë shpejt dhe i prerë: Petro Markoja të hiqej nga antologjia. Pas kësaj, - shton autorja - nuk do ta takoja, megjithëse isha e bindur se ai do të buzëqeshte paksa me atë buzëqeshjen karakteristike ku ndjehej hidhërimi i përmbajturi i njeriut, artistit të mësuar me ndalimin, me persekutimin."

Ende dhe sot kujtimet e Petro Markos "Intervistë me vetveten - (Retë dhe gurët)" vazhdojnë të mbeten një nga librat më të bukur të memorialistikës shqiptare, libër nga i cili kemi zgjedhur si epilog fjalët e Sejfulla Malëshovës, i cili në formë amaneti i thotë Petros për Partinë Komuniste Shqiptare, se: "Dëgjomë mirë! Ti ke milituar në partinë spanjolle (komuniste), në partinë franceze, në partinë italiane...Kjo parti këtu nuk është si ato. Kjo është një parti e krijuar nga dy serbë dhe është parti terroristësh. Ndaj më dëgjo mirë: nuk duhet të hapësh gojën të paktën një vit për ato që sheh dhe dëgjon. Përndryshe do ta pësosh..."



“Dëgjomë mirë! Ti ke milituar në partinë spanjolle (komuniste), në partinë franceze, në partinë italiane...Kjo parti këtu nuk është si ato. Kjo është një parti e krijuar nga dy serbë dhe është parti terroristësh. Ndaj më dëgjo mirë: nuk duhet të hapësh gojën të paktën një vit për ato që sheh dhe dëgjon. Përndryshe do ta pësosh...”

Dokumenti

Kërkesë e shkrimtarit Petro Marko drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme me 21 janar 1936 ku kërkon leje për të botuar revistën letrare “ABC”

“Ministrisë së Punëve të Brendshme”
Tiranë

I nënshkruari Petro Marko lindur më 1913, në Dhërmë të Himarës, kam nderin t' i lutem asaj P.T. Ministrije sa vijon:

Këtë vit do të jap provimet e fundit në Shkollën e Shkencave Politike t' Athinës. Qëllimi i em është që të merem me gazetarin. Dhe se qysh tani më jepet rasti të hyj në jetën e fletorizmes vendosa të nxjerr një të përkohshme me këto kondita:

Emrin do t' a ket: abc..

Do të dalë hëpërhë dy herë në muaj...



Do të shtypet në shtypshkronjën Nikaj, këtu në Tiranë.

Drejtor përgjegjës dhe pronar do të jet vetë i nënshkruari.

Do të jetë letrare e shoqërore me të vetmin qëllim që të bëhet e lehtë për këndim prej popullit, mbasi më tepër do të merret me subjekte që kanë të bëjnë me jetën e përditshme, me zakonet dhe përgjithësisht me frymën e thjeshtë të Shqiptarit duke e pasqyruar këtë me anë novelash, vjershash e shkrimesh të tjera letrare...Asnjë vijë, asnjë fjalë nuk do të përmendet nga jeta jonë politike. Vetëm letërsia popullore dhe problemet themelore të jetës s' onë shoqërore do të jetë qëllimi i botimit të së përkohshmes “abc...”

Prandaj, vij dhe i lutem nxehtësisht asaj P.T. Ministrije të ketë mirësinë e të më japë lejen për botimin e saj, mbasi e përkohshmja në fjalë do të dalë në ditët e para të muajit që vjen.

Me shpresë që lutja ime do të merret parasysh,
Mbetem me nderime P.Marko
Tiranë me 21-I-1936
Petro Marko
pranë Revistës
“Illyria”





Nga Ejup Lila



Super kompjuteri virtual

Efekt i kohë shpeshherë na pengon në arritjet e qëllimeve tona. Secilit nga ne i ka rastisur që të kërkoj ndihmë ose të bashkëpunojë më dikë për të arritur një qëllim të caktuar. Bashkëpunimi dhe koordinimi i mirë bën që efekti kohë të jetë më pak ndikues. Kjo vjen si pasojë se jo çdo person mund të jetë i aftë të kryej çfarëdo lloj detyre në një kohë të shkurtër.

Njerëzit për të arritur qëllimet e tyre përdorin edhe teknologjinë, në rastin më të zakonshëm, kompjuterin. Por, shpeshherë edhe pajisjet kompjuterike kanë kufizimet e tyre. Në këtë rast, edhe kompjuterat kanë nevojë për një bashkëpunim mes tyre. Ky bashkëpunim realizohet mes rrjeteve informatike, një term ky i dëgjuar për herë të para në fillim të viteve 1990.

Grid Computing është sistem, në të cilën, mbledhja e burimeve të shumta nga kompjuterat në vende të ndryshme, për të arritur një qëllim të përbashkët. Kompjuterat e këtij rrjeti janë të së njëjtës klasë kompjuterike. Një *Grid Computing* është i lidhur përmes një rrjeti super të shpejtë dhe i përbërë prej një sërë pajisjesh ndihmëse. *Grid Computing* është një zgjidhje me kosto efikase. Ky sistem ka

aftësinë e paralelizmit.

Një ndër strategjitë kryesore të këtij rrjeti informatikë është përdorimi i programeve të ndryshme në disa kompjuterat të ndryshëm, nganjëherë në mijëra dhe bashkimin e gjithë këtyre burimeve për të marrë një informacion të caktuar. Rrjetet informatike janë një formë e shpërndarë ku një "super kompjuter virtual" është i përbërë nga shumë kompjuterë në rrjet, të cilët veprojnë së bashku për të kryer detyra të ndryshme.

Madhësia e një rrjeti të tillë kompjuterik varjon nga rrjete të mbyllura të vogla brenda një korporate të vogël deri në rrjete me kompjuterat të shpërndara në një hapësirë gjeografike relativisht

të madhe. Kjo teknologji është aplikuar për përllogaritjet intensive në problemet shkencore, matematikore, akademike, në ndërmarrjet tregtare, në zbulimin e lëndëve narkotike, parashikimin e motit, parashikimet sizmike dhe në shumë fusha të tjera.

Puna e aplikacioneve koordinuese në rrjetet informatike ndonjëherë mund të jetë një detyrë komplekse, sidomos kur ky koordinim do bëhet nëpërmjet burimeve tepër të shpërndara dhe të kryqëzuara. Sistemet e rrjeteve informatike janë të projektuar dhe të specializuara për menaxhimin, ekzekutimin, manipulimin dhe kompozimin e të dhënave në kuadër të rrjetit.



Telefonat fleksibël

Ekranet e smartphonëve tashmë po bëhen të mërzitshëm. Ndryshimi i vetëm që është bërë në këto ekrane është vetëm rritja apo zvogëlimi i përmasave të ekranit, por është e njëjta formë e pandryshuar drejtkëndore. Pikërisht kompanitë e mëdha celulare po punojnë për devijimin nga kjo formë tashmë monotone.

Por si mund të jetë kjo formë? Po në qoftë se një mënyrë e re e zbuluar të ndryshojë rrënjësisht konceptin e smartphonëve dhe tabletave? Ekranet fleksibël mund të jenë përgjigje të pyetjeve të mësipërme. Një teknologji që mund të arrihet brenda gjysëm dekade, por me një investim miliarda dollarëshe.

Imagjinoni nëse smartphone juaj mund të marrë përmasa dhe forma të ndryshme, ose të vendosni një ekran të lakuar në kyçin e dorës suaj. Pamjet e fundit që qarkullojnë në internet kanë bërë që njerëzit të mendojnë se një teknologji e tillë është shumë afër. Njerëzit janë shumë të emocionuar dhe i presin me padurim produkte të tilla.

Në një prezantim të vitit 2011 *Nokia* performon një produkt për përdoruesit e saj, ku mund ta përkulje për ta kontrolluar. Me anë të forcës shtypëse që krijohet nga gishti, ju mund të telefononi apo t'ju përgjigjeni telefonatave. Kjo ishte një ide e zgjuar që filloj të ngacmoj imagjinatën e publikut, edhe pse në prezantim nuk tregohej se telefoni mund të merrte forma të ndryshme, si për shembull ta vendosësh në kyçin e dorës.

Ide të ngjashme kanë filluar të prezantojnë edhe kompanitë e mëdha, si: *Apple*, *Samsung*, *Philips*, *LG*, *Sony* dhe *Nokia*. *Apple* po punon mbi sjelljen e një produkti ku përdorimi bazë pritet të jetë me anë të presionit shtypës që krijon gishti. *Apple* pretendon të jetë i pari me këtë produkt dhe të jetë ai zotëruesi i patentës.




Gjithashtu, Samsung dhe LG kanë filluar të nxjerrin produktet e para me veti fleksibël. LG prezantoi televizionin e përkulshëm OLED, ku përqimi i dritës organike bëhej me anë të diodave. Modelet e ekraneve OLED janë më qetësues për sytë dhe ngjyrat dallohen më qartë.

Por a mundet një ekran fleksibël të ketë të njëjtin rezolucion, si telefonat mahnitës HTC One, Samsung Galaxy S4 dhe Iphone 5S? Nga ana praktike është shumë e vështirë që një ekran fleksibël të ketë pamje HD. Pamja në aparatet fleksibël nuk do të jetë aq e pastër sa është në ekranet e sotme OLED. Megjithatë, kualiteti do të vijë. Pritet që çdo telefon të bëhet fleksibël dhe me ekran OLED.

E gjithë kjo punë duket e lehtë në letër, por për të prodhuar një telefon të tillë nuk mjafton të bësh vetëm ekranin fleksibël, por duhen edhe komponentë të tjerë. Edhe nëse arrihet një ekran i tillë, në qoftë se bateria nuk është fleksibël do të pengoi në përkulshmërinë e telefonit. Shkencëtarët pretendojnë që këto produkte të dalin në treg në vitin 2018. Ata nuk lënë pa theksuar edhe çmimin, i cili pritet të jetë shumë i lartë.

Gjithsesi, produktet fleksibël nuk janë një e ardhme shumë e largët. Të gjithë po presin. Por, diçka është e sigurt, ne do kemi kohë të shijojmë edhe *Samsung Galaxy S5*, *Iphone 6* dhe produkte tjera të kompanive të ndryshme. Ne mbetemi në pritje të diçkaje të re mahnitëse.





Nga Blerand Ismaili



Misioni "De Biazi" dështoi?

Në prodhimet amerikane të "Hollywood", çdo film me fokus për futbollin ka pothuajse të njëjtin fillim dhe fund: një trajner i ri vjen, ndërton një skuadër të fortë dhe arrin sukses si kurrë më parë në historinë e atij klubi.

Për herë të parë në historinë e Kombëtares Shqiptare të futbollit kishim shanse reale për të qenë pjesë e kompeticionit më të rëndësishëm dhe prestigjioz, sic është Kupa e Botës, që do të zhvillohet në Brazil.

Në Kombëtaren tonë solli risi si asnjëherë më parë trajner italian Gianni de Biazi, një trajner i cili nuk kishte për motivim "të luajmë me zemër", siç ishim mësuar nga teknikët paraardhës të tij, ishte loja e hapur dhe sulmuese për të arritur fitore. Të shumtë ishin ata trajnerë të cilët merrnin pankinën e skuadrës së Shqipërisë dhe shfrytëzonin lojtarët të cilët ishin edhe senatorët e këtij ekipi, pa afruar lojtarë apo talente të rinj. Edhe kur përfshiheshin në ekip ishin të destinuar të dështonin, duke mos njohur ecuri pozitive në kombëtaren e futbollit dhe pjesën më të madhe të ndeshjeve e kalonin duke "ngrohur" stolin e pankinës.

Tekniku italian i emëruar në krye të Kombëtares tonë ishte nga grupi i atyre trajnerëve guximtar. De Biazi riformoi ekipin kombëtar, duke afruar talente të rinj, të panjohur më parë për tifozët

shqiptar. Ai theu mitin e njëmbëdhjetëshe së futbollistëve, të cilët në vitin 2004 mundën kampionen e sapo shpallur të Europës, Greqinë, duke ndërtuar një ekip, që bazohej vetëm në forcat e reja dhe në këmbët e talenteve shqiptar.

Analistët dhe specialistët e futbollit në vend u ndanë në dy kampe. Një grup mbështeste iniciativën e guximshme të italianit, ndërsa pjesa tjetër ishte skeptike për mënyrën e sjelljes së këtyre lojtarëve në ekip dhe trajnimit të tyre si të ishin fillestar.

Për herë të parë ekipi kombëtar kishte 2 skuadra të plota, kur para disa

vitesh trajner të ndryshëm që janë ulur në pankinën e Kombëtares tonë ankoheshin për mungesë lojtarësh dhe i justifikonin humbjet me lodhjen fizike dhe minutat e tepërta që luanin futbollistët.

Prurjet e reja, si : Kaçja, Basha, Rama etj. dhanë menjëherë efektin e duhur. Kombëtarja kishte një stil të ri loje, ku binte në sy organizimi në mesfushë me topa të bukur që luheshin në krah dhe mbrojtje agresive gjatë kundërsulmeve të kundërshtarëve. De Biazi solli në ekipin kombëtar lojtarë me moshë të vogël, por me talente të madh. Padyshim që qëllimi kryesor i Kombëtares ishte paraqitja e



denjë në fazën e grupeve eliminatore për botërorin "Brazil 2014," dhe kjo u vu re që në ndeshjen e parë.

Fitorja 3-1 përballë Qipros në "Qemal Stafa" i forcoi pozitën e teknikut italian dhe ishte një sinjal se diçka ndryshe po rilindte nga ky ekip.

Edhe pse humbjet me Zvicrën 2-0 dhe me Islandën 1-2 lëkundën besimin e tifozëve për një kualifikim të mundshëm në botëror, skuadra premtonte për vijueshmëri të rezultateve pozitive. Ky fakt, ashtu si edhe në vitet e mëparshme nuk ndodhi. Një tjetër ëndërr për tifozat "kuqezi" që do të duhet të presë edhe katër vite të tjera për të tentuar sërish të bëjnë mrekullinë. Ekipi kombëtar zhgënjën sërish tifozët dhe në qendër të kritikave u vu trajneri De Biazio për mënyrën e lojës.

Menjëherë ngrihet pyetja se kush është fajtor në këtë mes. Duhet të ndizen sirenat e alarmit, sepse të grumbullosh vetëm një pikë në katër ndeshje, një prej tyre me ekip modest është vërtetë shkak për të besuar se diçka nuk po shkon mirë.

Kombëtarja u formua si ekip me prurje nga jashtë vendit. Kampionati shqiptar është injoruar totalisht në "furnzimim" e Kombëtares me lojtarë. Djemtë e talentuar që luajnë jashtë Shqipërisë përveç sfidës së lojës duhet të përballen edhe me sfidën e ambientimit në një skuadër, ku të gjithë janë të rinj dhe nuk kanë stil loje të njëjtë.

Lënia pas dore e futbollit në Shqipëri, si një çështje jo e rëndësishme dhe përsëri rezultatet e saj. Një ekip i dështuar me pamundësi të ruajë vijimshmërinë e rezultateve pozitive u rikthye këtë vit në një fytyrë të shëmtuar në eliminatoret e botërorit.

Siç thotë edhe fjala e urtë popullore "Kur nuk ke çfarë t'i bësh gomarit, do t'i biesh samarit." E njëjta gjë ndodh edhe me Kombëtaren tonë. Për të justifikuar humbjet dhe paraqitjet e dobëta ndeshje pas ndeshje, i atribuojnë fajin lojtarëve shqiptar që luajnë për ekipe të tjera, si në rastin e Shaqirit, Xhakes e Berhamit, të cilët mbrojnë fanellat e Zvicrës. Këto lojtarë profesionist të talentuar përveç

se po përhapin emrin e Shqipërisë dhe Kosovës në botë me futbollin që luajnë, por gjithashtu janë shembull për taktikat e dështuara të Federatës tonë të Futbollit në përpjekje për tërheqjen e talentëve.

Federata Shqiptare e Futbollit deklaroi se po bën gjithçka për sigurimin e talentëve të rinj që luajnë jashtë vendit. Por këto pretendime hidhen poshtë nga menaxherët e futbollistëve, siç ishte ai i rasti të Adnan Januzajt. Talenti kosovar që luan për Manchester United në Angli ka hedhur poshtë zërat se ka marrë kërkesë zyrtare nga FSHF.

Shumë të vërteta po fshihen për tifozët e Kombëtares, që e vetmja gjë që duan është që futbollin në vendin tonë të mos konsiderohet si biznes dhe pazar, ku lojtarët dhe ndeshjet menxhohen sipas dëshirave të atyre që kanë kapitalin dhe pushtetin. Ajo që një komb futbolldashës kërkon është ta shohin ekipin tonë në majat e futbollit evropian dhe botëror.





KLINIKA DENTARE "VRIONI"

Cilësia, pasioni ynë.

IMPLANTOLOGJI IMEDIATE

Të gjithë ju që keni mungesë të një-disa ose të gjithë dhëmbëve dhe nuk dëshironi të qëndroni pa dhëmbë apo të mbani proteza të lëvizshme, mjafton një vizitë tek ne dhe brenda 24 orëve ju do të keni dhëmbë fiks (të pa lëvizshëm) mbi implante.

ORTODONCI

(Drejtimi i dhëmbëve)

Trajtim me aparate të lëvizshëm dhe fikse metalike, fikse qeramike (estetike të padukshme), Invisalign, për drejtimin e dhëmbëve dhe korigjimin e problemeve të kafshimit. Konsulta dhe studimi i rastiit falas.

PËR FËMIJËT

Shërbim i specializuar në një ambient të dizenuar enkas për fëmijët ku ata mjekohen, duke u relaksuar e argëtuar

SEDACIONI

Mjekimi nën efektin e Gazit Gazmor. Në rastet e frikës nga punimet dentare tek të rriturit apo fëmijët, kryhen punimet nën efektin qetësues të protoksidit të azotit.

STOMATOLOGJI ESTETIKE



Ndërthurje e materialeve të gjeneratës së fundit (IPS Epress, IPS E Max) me ndërhyrjet kirurgjikale për gingivat.

KIRURGJI ORALE

Ura Porcelani metal-porcelan, zirkonium, Alumina (ura krejt qeramike, pa metal)

SHËRBIM KOMPLEKS

Staf mjekësh profesionist, të diplomuar e specializuar në Turqi & Itali



Adresa:

Tek 21 Dhjetori, Rr. Fosina Plaku, ndërmjet hotel "Mondial" dhe Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit,
50 m. nga "Unaza". Tel: 04222 1637 Cel: 0672005000, 0684079989, 0692306899
www.vrionidental.com

Perfekte
si Ti...

Zgjidh paketën më të mirë për ty

Përfito 200 - 350 minuta

me të gjithë operatorët **kombëtarë** dhe ata në **Itali** e **Greqi**.

